

2016

Raporti i punës së Agjencisë  
Shtetërore për Mbrojtjen e të  
Drejtave të Fëmijëve dhe i  
strukturave të mbrojtjes së  
fëmijëve

## Pasqyra e Lëndës

Lista e shkurtimeve.....	3
Hyrje.....	4
Përmbledhje Ekzekutive .....	5
KAPITULLI I - Aktiviteti i ASHMDF për 2016.....	9
<b>1.1 Legjislacioni dhe Politikat e reja .....</b>	<b>10</b>
<i>Ligji 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve” .....</i>	<i>10</i>
<i>Ligji 37/2017 “Kodi i Drejtësisë për të Mitur” .....</i>	<i>12</i>
<i>Ligji 121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë” .....</i>	<i>13</i>
<b>1.2 Sensibilizimi dhe mobilizimi për mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha format e dhunës .....</b>	<b>16</b>
<b>1.3 Rritja e ndërgjegjësimit për mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge .....</b>	<b>21</b>
<b>1.4 Monitorimi i situatës së të drejtave të fëmijëve .....</b>	<b>22</b>
<b>1.5 Monitorimi i medias lidhur me problematikat e mbrojtjes së fëmijëve .....</b>	<b>23</b>
<b>1.6 Rritja e bashkëpunimit me partnerët .....</b>	<b>24</b>
<b>1.7 Standartizimi dhe dixhitalizimi i sistemit të referimit të rasteve të fëmijëve në rrezik .....</b>	<b>24</b>
<b>1.8 Raportimet/Aktivetet Ndërkombëtare .....</b>	<b>25</b>
<b>1.9 Ngritje e kapaciteteve të strukturave vendore për mbrojtjen e fëmijëve.....</b>	<b>26</b>
KAPITULLI II.....	26
<b>2.1 Të dhëna shifrore mbi rastet e fëmijëve në rrezik .....</b>	<b>26</b>
<b>2.1.1 Situata e raportimit nga Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve.....</b>	<b>27</b>
2.1.2 Raste në total .....	30
2.1.3 Rastet e reja sipas gjinisë, grupmoshës, etnisë .....	31
2.1.4 Numri i rasteve të fëmijëve të identifikuar/referuar sipas aktorëve.....	33
2.1.5 Raste të menaxhuara sipas nivelit të rrezikut .....	35
2.1.6 Rastet e mbyllura .....	36
2.1.7 Raste të fëmijëve të referuara nga NJMF-të në struktura të tjera .....	37
KAPITULLI III - Problematikat, natyra e rrezikut dhe llojet e abuzimit.....	38
<b>3.1 Problematikat e rasteve të menaxhuara nga Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve .....</b>	<b>38</b>
<b>3.2 Abuzimi i fëmijëve .....</b>	<b>46</b>
Neglizhimi .....	47
Abuzimi psikologjik .....	48

Abuzimi fizik.....	48
Abuzimi seksual .....	49
KAPITULLI IV .....	51
<b>4.1 Ndërhyrjet, shërbimet e ofruara për mbrojtjen e fëmijëve.....</b>	<b>51</b>
Shërbimet për fëmijët në situatë rruge.....	53
<b>4.2 Funksionimi i grupit teknik multidisiplinar (GTM) .....</b>	<b>54</b>
<b>4.3 Vizitat në familje.....</b>	<b>56</b>
<b>4.5 Problematikat e raportimit dhe punës për menaxhimin e rasteve.....</b>	<b>57</b>
<i>4.5.1 Problematika të konstatuara në menaxhimin e rasteve .....</i>	<i>57</i>
<i>4.5.2 Problematikat në plotësimin e raportimit të formularit.....</i>	<i>58</i>
ANEKS 1 – Formularët e raportimit .....	60
ANEKS 2 – Lista e NJMF-ve që kanë raportuar dhe numri i rasteve të menaxhuara për 2016 .....	63

## Lista e shkurtimeve

<b>AKDF</b>	Agjenda Kombëtare e të Drejtave të Fëmijës
<b>ASHMDF</b>	Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>MAS</b>	Ministria e Arsimit dhe Sportit
<b>MMSR</b>	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
<b>MPB</b>	Ministria e Punëve të Brendshme
<b>MSH</b>	Ministria e Shëndetësisë
<b>NE</b>	Ndihmë Ekonomike
<b>NJMF</b>	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës
<b>OBSH</b>	Organizata Botërore e Shëndetit
<b>OJF</b>	Organizatë Jo-fitimprurëse
<b>PMF</b>	Punonjës i Mbrojtjes së Fëmijëve
<b>PVF</b>	Plani i Veprimit për Fëmijët
<b>SHSSH</b>	Shërbimi Social Shtetëror
<b>VKM</b>	Vendimi i Këshillit të Ministrave

## Hyrje

Kur flitet për fëmijët nuk mund të mos mendosh për një fëmijë që është i gëzuar, i cili shpenzon kohë në lojëra dhe argëtime, ka mundësi të arsimohet, të shoqërohet dhe të pranohet nga shokët dhe mësuesit, është pjesë e një familje që e vlerëson, i mbron dhe kujdeset për ta. Por kjo nuk është ende situata në Shqipëri. Mbrojtja e një fëmije në rrezik ose subjekt i dhunës kërkon ndërhyrjen dhe bashkëpunimin e shumë aktorëve dhe profesionistëve të ndryshëm.

Matësi më i mirë i progresit të vendit tonë, drejt rrugëtimit për në Evropë, është mënyra se si i trajtojmë dhe i mbrojmë fëmijët sot dhe çfarë të ardhmeje u garantojmë atyre nesër. Ky është edhe qëllimi i hartimit të këtij raporti, mbi punën e bërë nga Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve përgjatë vitit 2016, për të kuptuar më shumë në lidhje me rastet e trajtuara, specifikat e rastit, identifikimin, referimin, mënyrën se si janë mbrojtur dhe trajtuar fëmijët, problematikat e hasura dhe sfidat për të ardhmen.

Raporti i përgjigjet një prej funksioneve kryesore të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve (ASHMDF), e cila ka përgjegjësi të monitorojë dhe të kontrollojë zbatimin e ligjit Nr.10347, datë 4.11.2010 “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve”, si dhe punën e Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijës (NJMF). Ky raporti hartohet në bazë të dhënave statistikore dhe informacioneve për situatën e mbrojtjes së Fëmijëve, që NJMF-të paraqesin çdo tre muaj dhe një herë në vit pranë ASHMDF-së.

Ligji Nr.10347, datë 4.11.2010 “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve”, në nenin 37, paragrafi 1, germa “h”, parashikon detyrimin e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve t’i paraqesë ministrit që bashkërendon punën për çështjet e mbrojtjes së fëmijës, brenda tremujorit të parë të çdo viti, raportin e vitit paraardhës për veprimtarinë e realizuar, për ecurinë e punës, problemet e hasura dhe për rrugët për kapërcimin e tyre, në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës. Përveç përmbushjes së detyrimit tonë ligjor, me këtë raport synojmë gjithashtu të identifikojmë problemet e hasura në fushën e mbrojtjes së fëmijës, rrugët për kapërcimin e tyre, adresimin e problematikave të identifikuara edhe nëpërmjet propozimeve për hartimin e politikave, ndryshimin e akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e të drejtave të fëmijëve si dhe përgatitjen e udhëzimeve metodologjike për NJMF-të.

## Përmbledhje Ekzekutive

Tabelë përmbledhëse 2015 - 2016<sup>1</sup>

	Viti 2015	Viti 2016
<b>NJMF zyrtare</b>	202	218
<b>Informacion mbi funksionimin e NJMF</b>		
Punonjës që kryejnë funksionin vetem si PMF	46	41
Punonjës që kryejnë detyrën si PMF dhe administrator social		94
Punonjës që kryejnë detyrën si PMF dhe specialist të dhunës në familje		11
Punonjës që kryejnë detyrën si PMF dhe specialistë për personat me aftësi të kufizuar		21
Punonjës që kryejnë detyrën si PMF dhe specialistë të barazisë gjinore		15
Punonjës kryejnë detyrën si PMF dhe funksione të tjera (që nuk përfshihen më sipër)		36
Punonjës që kryen detyrën si PMF dhe administrator i njësisë		1
Sipas ligjin të ri nevojiten punonjës që kryejnë detyrën vetëm si PMF		170
Sipas ligjin të ri nevojiten punonjës që kryejnë detyrën jo detyrimish PMF		251
<b>Profili I PMF</b>		
Punë Sociale		67
Nuk ka informacion		66
Nuk janë Punë Sociale		88
<b>NJMF që kanë raportuar</b>	124	141
<b>NJMF që kanë raportuar 0 raste</b>	72	58
<b>NJMF që kanë raportuar të paktën 1 rast</b>	52	83
<b>Raste të menaxhuar në total</b>	1403	1352
<b>Numri i rasteve të reja</b>	738	722
<b>Numri i rasteve të reja sipas grupmoshës</b>		
0-6 vjeç	251	265
7-14 vjeç	373	385
15-18 vjeç	114	72
<b>Numri i rasteve të reja sipas gjinisë</b>		
Femra	394	372
Meshkuj	344	350
<b>Numri i rasteve të reja sipas përkatësisë etnike</b>		
Rom	200	208
Egjiptian	160	99

<sup>1</sup> Tabela përmban të dhëna dhe informacion të përmbledhur (2015-2016) mbi numrin e njësisve të mbrojtjes së fëmijës, profilin e formimit të tyre, raportimin sipas numrit të rasteve të menaxhuara sipas problematikave dhe llojit të abuzimit, nivelet e rrezikut dhe mënyrës së identifikimit dhe referimit të rasteve. Gjithashtu janë përfshirë të dhëna për fëmijët në situatë ruge dhe ngritjen e kapaciteteve të strukturave vendore për mbrojtjen e fëmijëve.

Grekë		2
<b>Numri i rasteve të fëmijëve të identifikuar/referuar sipas aktorëve</b>		
NJMF	168	270
Policia	31	54
OJF	71	115
Prindi	73	57
Fëmija	4	4
Institucion arsimore	106	47
Institucion shëndetësore	9	2
Administratori i NE	90	55
Të tjerë	91	118
Raste të referuara nga Alo 116 111 pranë Agjencisë		44
Raste të referuara nga Alo 116 111 pranë NJMF		56
<b>Raste të menaxhuara sipas nivelit të rrezikut</b>		
Nivel i ulët	570	475
Nivel i mesëm	431	634
Nivel i lartë	167	186
Emergjent	107	57
<b>Rastet e mbyllura</b>		
Fëmija është mbi 18 vjeç	49	39
Është reduktuar niveli i rrezikut, në rrezik të ulët/mungesë rreziku	137	287
Fëmija jashtë rrezikut deri 18 vjeç	33	29
Fëmija vdes	0	0
Fëmija është transferuar në një vendbanim tjetër	61	87
Total i rasteve të mbyllura	285	442
<b>Numri i rasteve të fëmijëve në ndjekje, sipas problematikave</b>		
Dhunë në familje	155	150
Trafikim	15	17
Shfrytëzim fëmije	285	318
Probleme ekonomike	645	588
Aftësi e kufizuar	29	30
Mosregjistrim	35	53
Braktisje shkollore	72	96
Tjetër	60	100
<b>Numri i rasteve të fëmijëve në ndjekje sipas llojit të abuzimit</b>		
Abuzim fizik	71	104
Abuzim seksual	26	27
Abuzim psikologjik	106	186
Neglizhim	352	619
Raste të fëmijëve të referuara nga NJMF-të në struktura të tjera	272	192

NJMF që kanë plotësuar Formularin B	76	90
Raste të referuar në strukturat e mbrojtjes së fëmijëve të publikuara nga media nga ASHMDF		120
Ankesa zyrtare tek AMA		9
Sinjalizime tek operatorët mediatike lidhur me shkeljet e konstatuara		20
<b>Ngritje e kapaciteteve të strukturave vendore për mbrojtjen e fëmijëve</b>		
Ekipe në terren dhe punonjësit e institucioneve dhe organizatave vendore për identifikimin e fëmijëve në situatë rruge në bashkitë e Shkodrës, Korçës, Vlorës të trajnuar		33
Numri i profesionistëve në trajnime në 12 qarqet e vendit me teme: "Regjistrimi i fëmijëve dhe kujdesin familjar"		350
Nr i profesionistëve në trajnime te Grupeve Teknike Multidisiplinare dhe Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve në 10 qarqet e Shqipërisë		262
Nr i profesionistëve në trajnime me inspektorët e punës, dhe me Njësitë e Mbrojtjes së fëmijëve lidhur me inspektimin e standardeve të mbrojtjes së fëmijëve		194
<b>Të dhëna për fëmijet në situatë rruge</b>		
Skuadra terreni për identifikimin e fëmijëve në situatë rruge në bashkitë Tiranë, Shkodër, Durrës, Elbasan, Fier, Korçë dhe Vlorë		24
Fëmijë në situatë rruge të identifikuar		479
Fëmijë të larguar nga situata e rrugës		345
Fëmijë që janë regjistruar dhe frekuentojnë shkollën		341
Prindër të fëmijëve në situatë rruge të punësuar		103
Raste të fëmijëve që për arsye të ndryshme u mungon kujdesi prindëror		49
Raste të fëmijëve me probleme shëndetësore		20
Fëmijë që janë trajtuar me shërbime në qendrat e emergjencës në gjithë vendin		52
NJMF që e kanë mbledhur GTM		55
Vizitat në familje	1955	1740

Raporti paraqet punën e bërë nga NJMF-ve përgjatë gjithë vitit 2016. Ai është i ndarë në tre kapituj. Çdo kapitull është strukturuar në mënyrë që të paraqesë situatën aktuale, progresin e bërë, si dhe identifikojë problematikat e konstatuara dhe sfidat për realizimin e plotë të drejtave dhe mbrojtjen efektive të fëmijëve.

Kapitulli i parë i raportit flet për legjislacionin dhe hartimin e politikave të reja si dhe aktivitetin e ASHMDF-së për vitin 2016. Kapitulli i dytë fokusohet në të dhënat statistikore mbi rastet e fëmijëve në rrezik të menaxhuara nga Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve. Kapitulli paraqet situatën e raportimit, rastet në total të menaxhuara nga NJMF-të, rastet e reja, rastet e menaxhuara sipas nivelit të rrezikut, rastet e mbyllura, arsyet e mbylljes së rastit, si dhe rastet e fëmijëve të referuara nga NJMF në struktura të tjera. Kapitulli i tretë i raportit hedh vështrimin mbi problematikat dhe natyrën e rrezikut të rasteve të trajtuara, llojet e abuzimit, ndërhyrjet dhe shërbimet e ofruara për mbrojtjen e fëmijëve.

Nga 218 NJMF që janë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, për vitin 2016 kanë raportuar 141 NJMF. Nga të dhënat e raportuara rezulton se për vitin 2016 NJMF kanë trajtuar 1352 raste në total, nga ku 722 janë raste të reja dhe pjesa tjetër janë raste të mbartura nga vitet e



kaluara. Për vitin 2016 rezultojnë 442 raste të mbyllura. Rastet e raportuara paraqiten me problematika të ndryshme si: probleme ekonomike 588 raste, dhunë në familje 150 raste, trafikim 17 raste, fëmijë të shfrytëzuar 318 raste, aftësi e kufizuar 30 raste, braktisje shkollore 96 raste, mosregjistrim të fëmijëve në Gjëndjen Civile 53 raste, si dhe problematika të tjera 100 raste.

Nga krahasimi i shifrave dhe informacionit mbi mënyrën e menaxhimit të rasteve rezulton që:

1. Ka një rritje të cilësisë së punës së NJMF-ve si në menaxhimin e rasteve të fëmijëve në rrezik, po ashtu edhe për raportimin e punës së tyre.
2. Problemet ekonomike zënë vendin kryesor të problematikave të trajtuara nga NJMF;
3. Për vitin 2016 vërehet një rritje e rasteve të trajtuara për fëmijët e shfrytëzuar kryesisht për lypje apo punë të tjera në rrugë;
4. Dhuna në familje është një nga format më të raportuara të dhunë;
5. Ka rritje të numrit të çështjeve të trajtuara për fëmijë të paregjistruar në Gjëndjen Civile;
6. Ka rritje e numrit të rasteve të menaxhuara për braktisje shkollore.

Përveç problematikave të sipërpërmendura ka dhe raste që trajtohen për më shumë se një problematikë. Kryesisht problemet ekonomike të familjeve lidhen dhe me problematika të tjera si ato shëndetësore, apo përkujdesit prindëror, strehim dhe punësim.

## KAPITULLI I - Aktiviteti i ASHMDF për 2016

Përgjatë vitit 2016, ASHMDF ka patur në fokus të saj këto objektiva kryesorë:

1. Hartimin e propozimeve ligjore dhe politikave të reja për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve. Në këtë drejtim gjatë vitit 2016 është punuar për hartimin e Ligjit “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve” dhe Agjendës Kombëtare për të Drejtat e fëmijëve 2017-2020.
  - i. Realizimi i këtij objektivi është raportuar në seksionin 1.2 të këtij kapitulli.
2. Monitorimi i punës së strukturave vendore për Mbrojtjen e fëmijëve, nëpërmjet mbledhjes dhe analizimit të të dhënave dhe hartimi i raportit vjetor.
  - i. Realizimi i këtij objektivi është raportuar në Kapitujt II, III dhe IV të këtij raporti.
3. Koordinimi i zbatimit dhe monitorimi i Planit Kombëtar për Fëmijët në Situata Rruge 2015-2017. Rezultatet kryesore në këtë fushë përfshijnë:
  - a. Miratimin e planeve lokale për fëmijët në situata rruge në 7 bashki
  - b. Përditësimi në nivel kombëtar i databazes së fëmijëve në situata rruge dhe hartimi i raporteve të monitorimit.
  - c. Koordinimi me institucionet në nivel qendror për adresimin e problematikave.
  - d. Ngritja e kapaciteteve të aktorëve për identifikimin dhe menaxhimin e fëmijëve në situata rruge.
    - i. Realizimi i këtij objektivi është raportuar në Kapitujt II, III dhe IV të këtij raporti.
4. Sensibilizimi dhe mobilizimi i institucioneve publike dhe jopublike në nivel qendror dhe vendor, i fëmijëve dhe i prindërve për mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha format e dhunës.
5. Forcimi i kapaciteteve të strukturave të mbrojtjes së fëmijëve në nivel vendor lidhur me zbatimin e legjislacionit, procedurave të mbrojtjes së fëmijëve, identifikimin pro-aktiv dhe bashkëpunimin ndër-sektorial.
6. Monitorimi i situatës së të drejtave të fëmijëve nëpërmjet indikatorëve të VKM 267/2012.
7. Monitorimi i medias lidhur me problematikën e mbrojtjes së fëmijëve dhe raportimin etik të rasteve të fëmijëve.
8. Propozimet për standartizimin dhe dixhitalizimin e sistemit të referimit, ruajtjes së të dhënave dhe monitorimit të rasteve të fëmijëve në rrezik.
9. Përfaqësimi i Shqipërisë në institucionet ndërkombëtare, raportimi në kohë dhe me cilësi për çështjet e të drejtave të fëmijëve, dhe promovimi i standarteve ndërkombëtare me aktorët institucionalë dhe partnerët.
10. Rritja e bashkëpunimit me aktorët jo-qeveritarë që punojnë në fushën e të drejtave dhe të mbrojtjes së fëmijëve.
  - i. Realizimi i objektivave 4-10 janë raportuar në seksionet 2-9 të këtij Kapitulli.

## 1.1 Legjislacioni dhe Politikat e reja

### *Ligji 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve”*

Në shkurt të vitit 2017 u shënuar një arritje e rëndësishme në mbrojtjen, promovimin dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri me miratimin e Ligjit 18/2017, “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”, i cili hyn në fuqi në qershor të vitit 2017. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, Ligji nr.10347, datë 4.11.2010 “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve”, shfuqizohet.

Kryetarja e ASHMDF Znj. Ina Verzivolli, ka qenë pjesë e grupit të punës për hartimin e ligjit. ASHMDF ka udhëhequr të gjithë procesin e hartimit të ligjit, organizimin e takimeve konsultative dhe reflektimin e komenteve. Ligji është hartuar me ndihmën e dy eksperteve të kontraktuar nga UNICEF. Për konsultimin e ligjit janë organizuar 7 takime konsultative me grupet e interesit, përfaqësues të institucioneve në nivel qendror dhe vendor, profesionistët që punojnë me fëmijët, shoqërinë civile, studentët dhe pedagogët e Fakultetit të Shkencave Sociale dhe është dërguar për konsultim të brendshëm në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave, Ministria e Arsimit, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Çështjeve Vendore, Ministria e Integritimit Evropian, si dhe një sërë takimesh bilaterale me aktorë të ndryshëm. Janë trajtuar gjithashtu mbi 20 komente me shkrim nga aktorët e shoqërisë civile.

Ligji, siç e tregon edhe titulli, flet si për të drejtat në përgjithësi të fëmijës, ashtu edhe për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna, abuzimi, shfrytëzimi apo neglizhimi. Ai sjellë një tjetër qasje ndaj mënyrës se si garantohen të drejtat e fëmijës, si dhe vendos fokusin në ngritjen e një sistemi të integruar të mbrojtjes duke propozuar ndërhyrje dhe masa konkrete të mbrojtjes që duhet të merren nga strukturat përgjegjëse për të parandaluar, rehabilituar ose mbrojtur në vazhdimësi fëmijën që është subjekt i dhunës, abuzimit, neglizhimit ose potencialisht i tillë.

Për të hartuar këtë projekt-ligj janë marrë në konsideratë legjislacionet më të mira të vendeve evropiane, duke kërkuar dhe synuar përshtatjen me kontekstin kulturor dhe institucional vendas. Në këtë drejtim ligji shkon drejt standardeve më të përparuara evropiane, për të garantuar mbrojtjen e fëmijës në çdo situatë, brenda familjes, në institucione, online, etj.

Vizioni i sistemit të mbrojtjes së fëmijëve që ligji përqafon, rrjedh drejtpërdrejtë nga dokumenti i politikave “E ardhmja e sistemit të integruar për mbrojtjen e fëmijëve në Shqipëri”, “Vizioni për përmirësimin e rezultateve të fëmijëve në Shqipëri përmes një sistemi të efektshëm të integruar për mbrojtjen e fëmijës”, të përgatitur nga Znj. Anniki Lai, eksperte në Këshillin e Evropës. Ky vizion mbështetet mbi themelet e sistemit që janë hedhur që me Ligjin “ Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës” së 2010, sidomos duke u bazuar në praktikat e mira dhe modelet pozitive të ngritura në disa zona ku është punuar me përkushtim. Megjithatë ligji ngre në një tjetër nivel sistemin e mbrojtjes së fëmijëve duke forcuar garancitë për ndërhyrje efektive dhe ndërsektoriale të integruara për parandalimin, mbrojtjen dhe rehabilitimin e fëmijëve që janë në situata rreziku apo kanë nevojë për mbrojtje.

Ligji vendos standardin që në çdo njësi administrative të bashkisë, e cila ka më shumë se 3000 fëmijë, të ketë minimalisht, një punonjës për mbrojtjen e fëmijës. Ata nuk mund të angazhohen në detyra të tjera brenda njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit. Në rastet kur njësi administrative e bashkisë ka më pak se 3000 fëmijë, këtë detyrë mund ta kryejë njëri nga punonjësit e njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit, i cili ka të përcaktuar në përshkrimin e punës, funksionin si punonjës për mbrojtjen e fëmijës.

Shërbimi i mbrojtjes së fëmijëve duhet të jetë aktiv 24 orë në ditë, në cdo njësi të qeverisjes vendore. Për këtë qëllim, do të duhet që bashkitë të marrin masa për të garantuar shërbime të ndërhyrjes dhe pritëse për tu ardhur në ndihmë fëmijëve në çdo orë të ditës apo të natës.

Për herë të parë, përcaktohet qartë se çfarë do të thotë mbrojtje e fëmijës, duke qartësuar se cilat janë masat e mbrojtjes që mund të aplikojnë këta punonjës, kur konstatojnë raste të fëmijëve që janë në situatë të pasigurt për shkak të dhunës, abuzimit, neglizhimit apo shfrytëzimit. Këto përfshijnë, masat emergjente për ta larguar fëmijën nga një situatë rreziku në mënyrë të menjëhershme, siç mund të jetë një fëmijë në situatë rruge, apo një fëmijë i gjetur i neglizhuar rëndë në banesë. Në disa raste të tjera, mund të merret masa për ta larguar fëmijën nga familja dhe për ta vendosur në përkujdesje alternative kur vetë familja mund të rrezikojë integritetin dhe sigurinë e fëmijës. Gjithashtu ligji parashikon si masë mbrojtje mbikëqyrjen e specializuar të fëmijës në mjedisin familjar. Mbikëqyrja e specializuar në mjedisin familjar vendoset si masë mbrojtjeje për fëmijën, i cili ka mundësi të trajtohet dhe të mbrohet brenda familjes, duke u monitoruar me një plan të përcaktuar nga strukturat e mbrojtjes së fëmijës.

Përveç masave të mbrojtjes ligji parashikon edhe mbrojtjen e posaçme për kategori të caktuara fëmijësh, të cilat mund të vendosen për çdo fëmijë në situatë të tillë që kërkon mbrojtje. Ligji parashikon mënyrën e ndërhyrjes dhe hapat që ndërmerren për mbrojtjen e tre kategorive të cilësuar të fëmijëve, më konkretisht atyre të abuzuar, dhunuar, neglizhuar, fëmijëve të shfrytëzuar ekonomikisht dhe fëmijëve të cilët akuzohen se kanë kryer vepra penale por janë nën moshën për përgjegjësi penale.

PMF-ja investohet me autoritetin që kanë punonjës të tillë në të gjitha vendet e përparuara, duke bërë që interesi më i lartë i fëmijës të prevalojë mbi çdo interes tjetër, përfshirë dhe atë prindëror. Sipas këtij ligji, nëse fëmija merret në mbrojtje, automatikisht e drejta e prindërimit do të pezullohet dhe me këtë është mbyllur një hendek i madh ligjor, pasi deri me tani ka qenë e pamundur të merrej fëmija në mbrojtje nëse prindi nuk ishte dakord.

Njëkohësisht, ligji e bën shumë të qartë se detyrimi kryesor për të garantuar fëmijës zhvillim, mirërritje, arsim dhe shëndetësi është i familjes, është i prindërve. Shteti ka detyrë të ndihmojë familjen kur ajo është në nevojë dhe ka nevoje për ndihmë. Për këtë arsye ligji propozon masa të aftësisimit prindëror, për të ndihmuar prindërit që të përmbushin detyrimin e tyre prindëror, në interes të fëmijës, pasi qëllimi në këtë ligj, dhe qëllimi ynë është që fëmija të rritet pranë familjes, dhe vetëm kur rrezikohet të ndahet prej saj.

Pushteti Vendor tashmë ka një rol të rëndësishëm për garantimin e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve. Eksperiencat me të mira evropiane tregojnë se shërbimi më i mirë për fëmijët dhe familjen jepet në territor, aty ky fëmijët jetojnë.

Në çdo bashki do të ketë Grupe Ndërsektoriale për mbrojtjen e fëmijëve, me pjesëmarrje të aktoreve kryesore: të arsimit, shëndetësisë, policisë, shërbimeve sociale. Mbrojtja e fëmijës ka nevojë për ndërhyrjen e të gjithë këtyre aktorëve, dhe nuk mund të bëhet vetëm nga punonjësit socialë. Ky mekanizëm ligjor mundëson një ndërhyrje ndër-sektoriale të koordinuar.

Një risi e rëndësishme është detyrimi që kanë tashmë të gjithë profesionistët që punojnë me fëmijët për raportim të çdo rasti të dyshuar apo të ndodhur të abuzimit, keqtrajtimit apo dhunës tek fëmijët. Ky detyrim përfshin mësuesit dhe psikologët e shkollave, punonjësit e institucioneve shëndetësore apo të përkujdesjes së fëmijës, publike ose privatë. Në rast mospërbushje të detyrimeve të parashikuara në ligj ASHMDF ka të drejtën të vendosë sanksione ndaj personave fizikë ose juridik.

### ***Ligji 37/2017 “Kodi i Drejtësisë për të Mitur”***

Në datën 30 mars 2017, në Parlament u miratua Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur. Kodi hedh bazat për një drejtësi miqësore për fëmijët dhe se bashku me Ligjin 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve" siguron realizimin e një sistemi të integruar dhe efektiv për mbrojtjen fëmijëve.

Qëllimi i “Kodi i Drejtësisë për të Miturit” është mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës, integrimi social i tyre, rehabilitimi i fëmijëve në konflikt me ligjin, mbrojtja e të drejtave të fëmijëve dëshmitar dhe viktimë, parandalimi i viktimizimit të dytë ose ri-viktimizimit, parandalimi në kryerjen e veprës penale dhe sigurimi i rendit publik gjatë administrimit të drejtësisë.

Nëpërmjet këtij ligji, garantohet një qasje e plotë e drejtësisë miqësore për fëmijët. Drejtësia miqësore për fëmijët nënkupton garantimin e respektit dhe efektivitetin e zbatimit të gjithë të drejtave të fëmijëve, në nivelin më të lartë të arritshëm, në sistemet e drejtësisë së një vendi. Për këtë, në veçanti, kërkohet që drejtësia të jetë e aksesueshme, e përshtatur sipas moshave, e shpejtë, e fokusuar në nevojat dhe të drejtat e fëmijëve. Kjo përfshin të drejtën për një proces të rregullt ligjor, të drejtën për pjesëmarrje dhe për të kuptuar procedurat, të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare, si dhe të integritetit dhe dinjitetit. Kodi parashikon norma specifike procedurale për organet përgjegjëse gjatë procedurës së administrimit të drejtësisë, norma specifike procedurale që duhet të respektohen në proceset penale që afektojnë fëmijët si dhe rregulla të posaçme për ekzekutimin e vendimeve dhe masave të tjera.

Kodi garanton që sistemi i drejtësisë penale për fëmijët në Shqipëri të shikohet në mënyrë integrale dhe multidisiplinore. Shërbimet sociale, arsimore, policia e shtetit, shërbimi i provës, e prokuroria duhet të bashkëpunojnë jo vetëm në parandalimin, por edhe në përcaktimin e masave restauruese më të përshtatshme për fëmijët në konflikt me ligjin dhe sidomos për rehabilitimin e tyre.

PMF është personi mbështetës në rastet me të miturit dëshmitar ose viktimë të veprave penal. PMF ka për detyrë të ofrojë mbështetje gjatë gjithë procesit penal. Kjo ndihmë mund të përfshijë masa për minimizimin e pasojave negative të veprës penale, masa për të ndihmuar të miturin në veprimtarinë e përditshme dhe masa për të ndihmuar të miturin në raport me çështjet

administrative që mund të lidhen me rrethanat e rastit konkret. Të këshillojë për ndjekjen e një terapie ose këshillimi profesional. Shumë e rëndësishme është që NJMF të ruajë komunikimin me të afërmit, shokët dhe avokatin e fëmijës si dhe të informojë fëmijën për gjendjen e tij procedurale si dhe shërbimet shëndetësore, psikologjike ose sociale dhe mënyrat e mundshme të marrjes së këtyre shërbimeve.

Gjithashtu NJMF-të përpilojnë listën e përfaqësuesve procedural që do të kryejnë përfaqësimin procedural të fëmijës në mungesë të përfaqësuesit të tij ligjor ose, në rast konflikti interesi mes tij dhe fëmijës dhe ka të drejta përfaqësuese në emër të fëmijës në konflikt me ligjin, ose fëmijës dëshmitar/viktimë, me qëllim për të mbrojtur interesin më të lartë të fëmijës.

### ***Ligji 121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”***

Një hap i rëndësishëm u hodh me miratimin e Ligji Nr.121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, i cili ka si qëllim përcaktimin e rregullave për sigurimin dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, në shërbim të mirëqenies dhe përfshirjes shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror. Ligji përcakton llojet e përfitimeve dhe lehtësive për individët dhe grupet e individëve që përmbushin kushtet për të përfituar, si dhe procedurat e kërimit e të përfitimit të të drejtave të shërbimeve të kujdesit shoqëror, rolin dhe përgjegjësitë e organeve publike dhe jopublike të ngarkuara me zbatimin e këtij ligji.

Në kuadër të procesit të deinstitutionalizimit garantohej që Shërbimet e kujdesit shoqëror sigurohen dhe ofrohen, për aq sa është e mundur, pranë familjes ose komunitetit të përfituesit të shërbimit, me qëllim sigurimin e mirëqenies shoqërore dhe përdorimin me efikasitet të fondeve. Ligji përcakton si kategori përfituese, çdo fëmijë, të miturit dhe të rinjtë në konflikt me ligjin, që kanë përfunduar periudhën e dënimit dhe kanë nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror, me qëllim riintegrimin në shoqëri, si dhe ata që gëzojnë mbrojtje ndërkombëtare me vendim të autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët në Republikën e Shqipërisë. Ligji ngre një sërë shërbimesh siç janë shërbime rezidenciale të cilat janë shërbime të kujdesit njëzetekatërorësh dhe afatgjatë për individë në nevojë (fëmijë ose të rritur), të ofruara në qendrat rezidenciale, publike dhe jopublike. Shërbime komunitare, që janë shërbime që ofrohen në qendra komunitare lokale ose në mjedise të tjera, si shërbimet e kujdesit ditor apo të zëvendësimit të përkohshëm të kujdestarit për të gjitha kategoritë e përfituesve të shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Ligji gjithashtu ngre shërbimet parashoqërore të cilat janë shërbime që përfshijnë informimin e përfituesve të shërbimeve të kujdesit shoqëror nga ofruesit e shërbimeve, ndihmën për përfituesit në përcaktimin e nevojave të tyre, vlerësimin fillestar, mbështetjen dhe ndihmën për zgjedhjen që u përshtatet nevojave të përfituesit në sistemin e shërbimeve shoqërore.

Shërbimet në familje janë një tjetër formë e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat ofrohen në familje për kategoritë në nevojë, që e kanë të pamundur të marrin shërbime komunitare, ditore dhe rezidenciale.

Shërbime të specializuara, janë shërbimet e ofruara nga profesionistë të profilizuar në specialitete të ndryshme. Këto shërbime ofrohen në nivel qarku/rajonat dhe bashkie për fëmijët me çrregullime

pervazive të zhvillimit, prapambetje mendore, çrregullime në komunikim, në nevojë për aftësim fizik, fëmijët e abuzuar seksualisht, fëmijët në konflikt me ligjin, si dhe gratë e vajzat e abuzuara, të dhunuara apo të trafikuar, si dhe të gjitha kategoritë që kanë nevojë për shërbime të tilla.

Për administrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror pranë bashkive ngrihen struktura të posaçme për shërbimet e kujdesit shoqëror. Pranë çdo njësie administrative, në varësi të bashkisë, ngrihet njësi e vlerësimit të nevojave dhe referimit. Bashkia cakton nga një punonjës social të njësisë së qeverisjes vendore për gjashtë deri në dhjetë mijë banorë. Bashkitë, me numër popullsie më pak se gjashtë mijë banorë, orientohen dhe mbështeten në funksionet e tyre nga zyrat rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.

### ***Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017-2020***

Zbatimi i ligjit në praktikë do të kërkojë bashkëpunimin e shumë sektorëve, pushtetit qendror me atë lokal, por edhe ndihmën e aktorëve jo-qeveritarë.

Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017 – 2020 (AKDF)<sup>2</sup> shpreh angazhimin e qeverisë shqiptare për promovimin, mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të fëmijëve. Agjenda synon të përmbushë këtë mision duke iu përmbajtur/integruar standardeve më të larta kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e të drejtave të fëmijëve. Vizioni i saj është të krijojë kushte të favorshme për zhvillimin e shëndetshëm fizik dhe psikosocial të fëmijëve, përfshirjen sociale dhe pjesëmarrjen e tyre në të gjitha proceset, bazuar në interesin më të lartë të fëmijës.

Pas përfundimit të Planit të Veprimit për Fëmijë 2012-2015, ASHMDF dhe MMSR filluan procesin e hartimit të dokumenti të ri strategjik. Me urdhër të Ministrit të MMSR në 13 qershor 2016 u ngrit një grup ndërinstytucional pune, i cili ka punuar për hartimin e AKDF-së së bashku me dy eksperetë të kontraktuar nga UNICEF. Pjesë e grupit të punës për hartimin e AKDF ishte dhe Kryetarja e ASHMDF-së, Znj. Ina Verzivolli.

AKDF është hartuar përmes një procesi konsultimi ku kanë marrë pjesë përfaqësues nga institucionet shtetërore në nivel qendror dhe vendor, organizatat e shoqërisë civile, kryesisht ato që kanë në fokusin e tyre fëmijët, si dhe komuniteti ndërkombëtar.

AKDF është dokumenti i parë politik i cili është konsultuar me fëmijët. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në bashkëpunim me organizatën Eorld Vision organizuan në nëntor 2016 konsultimin e draft AKDF-së me fëmijët.

AKDF përfaqëson një dokument strategjik, i cili shpreh prioritetet e institucioneve shtetërore në fushën e të drejtave të fëmijëve, si dhe njëkohësisht, një kuadër të unifikuar për monitorimin e

---

<sup>2</sup> VKM nr 372, date 26.04. 2017 “Për miratimin e Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017-2020” është botuar ne Fletoren Zyrtare nr.100/2017 , datë 9 maj .

progresit të Qeverisë shqiptare drejt realizimit të të drejtave të fëmijëve, në të gjithë sektorët relevantë.

Qasja e përdorur si bosht për Agjendën është ajo e të **drejtave të fëmijëve**. Kjo qasje e konsideron çdo fëmijë një qenie njerëzore unike dhe njëlloj të vlefshme (mos – diskriminimi, Neni 12), që ka të drejtë jo vetëm për të jetuar dhe mbijetuar por edhe për zhvillim deri në arritjen e potencialit të vetë maksimal (neni 6). Fëmijët mund të shprehin pikëpamjet e tyre duke ndihmuar këdo që të kuptojë më mirë situatën në të cilën gjenden, ata mund të kontribuojnë aktivisht me përvojën e tyre (pjesëmarrja – neni 12). Fëmijët meritojnë t'i plotësohet interesi më i lartë (Neni 3) përmes alokimit të burimeve dhe zbatimit të të drejtave të parashikuara në KKBD (Neni 4).

Shtyllat strategjike të Agjendës janë: (i) Mirëqeverisja në funksion të promovimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve; (ii) Eliminimi i të gjitha formave të dhunës për fëmijët; dhe (iii). Sisteme dhe Shërbime miqësore për fëmijët dhe adoleshentët: zhvillimi dhe arsimimi, drejtësia, shëndetësia dhe ushqyerja, dhe mbrojtja sociale.

AKDF synon përmirësimin e qeverisjes në funksion të promovimit, respektimit dhe garantimit të të drejtave të fëmijëve duke synuar përfundimin e kuadrit rregullator dhe institucional, përfshirë mekanizmat e pavarur monitorues, përmirësimin e monitorimit të situatës së të drejtave të fëmijëve në mënyrë që të gjenerohen të dhëna që ushqejnë politika efektive, si dhe ngritjen e mekanizmave pjesëmarrës të fëmijëve në vendim-marrje.

Angazhimi për eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj fëmijëve konfirmohet si një prioritet i rëndësishëm i qeverisë, nëpërmjet një qasjeje të integruar sistemike. AKDF synon ngritjen e një sistemi të integruar dhe efektiv për mbrojtjen e fëmijëve nëpërmjet një kuadri ligjor dhe institucional të përmirësuar ndjeshëm. Objektivat dhe aktivitetet për mbrojtjen e fëmijëve janë hartuar në përputhje me Dokumentin e politikave “E ardhmja e sistemit të integruar për mbrojtjen e fëmijës në Shqipëri

Në pjesën e tretë AKDF synon nxitjen e proceseve dhe sistemeve miqësore me fëmijët, si në arsim, shëndetësi, shërbime shoqërore, dhe drejtësi. Në këtë aspekt është synuar më së shumti evidentimi i masave kryesore të strategjive sektoriale për të arritur vlerësimin e progresit të të drejtave të fëmijëve në këto fusha.

Masat dhe aktivitetet e parashikuara në këtë agjendë kanë kryesisht natyrë ndërsektoriale për të adresuar nevojat për parandalim, mbrojtje, ndërhyrje afatgjata, ofrimin e shërbimeve miqësore ndaj fëmijëve dhe adoleshentëve dhe promovimin e të drejtave duke adresuar normat sociale. Natyra e objektivave dhe e ndërhyrjeve është njëkohësisht holistike, duke synuar një impakt më të madh në jetën e fëmijëve.



## 1.2 Sensibilizimi dhe mobilizimi për mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha format e dhunës

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve dhe Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, me mbështetjen e partnerëve, duke nisur që nga marsi 2016 ndërmoi një Plan Mobilizimi Kombëtar **#UnëMbrojFëmijët**<sup>3</sup>, për mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha format e dhunës. Plani i mobilizimit bëri të mundur hapjen e një debati të gjerë mbi mbrojtjen e fëmijëve, duke angazhuar të gjithë shoqërinë për mbrojtjen e tyre nga çdo formë e dhunës, mbi rëndësinë e raportimit të rasteve të dhunës, si dhe përmirësimin e shërbimeve për fëmijët.

Synimi i planit ishte ndërgjegjësimi i të gjithë publikut të gjerë për denoncimin dhe raportimin e rasteve të dhunës ndaj fëmijëve

Gjatë këtyre tre muajve #UnëMbrojFëmijët ka përfshirë 26 bashki (Tiranë, Durrës, Elbasan, Fier, Lushnjë, Vlorë, Shkodër, Korçë, Dibër, Kamzë, Lezhë, Librazhd, Kurbin, Burrel, Cërrik, Përmet, etj) jemi takuar me 10'000 prindër, 20'000 fëmijë e 2'000 mësues. Mesazhi #UnëMbrojFëmijët është përhapur 3'000 herë në rrjetet sociale.

Gjatë këtij Plani Mobilizimi është nënshkruar marrëveshja midis ASHMDF-së Linjës së Këshillimit Alo 116 111, ku çdo fëmijë, prind, profesionist apo çdo qytetar ka një numër (116 111) ku mund të raportojë dhunën ndaj fëmijëve. Eshtë lancuar aplikacion i ri #UnëMbrojFëmijët, si një nga mjetet për të raportuar dhunën ndaj fëmijëve në një anonim të plotë. Janë zhvilluar shumë takime e trajnime me prindër e profesionistë që punojnë me fëmijët, duke i njohur ata me përgjegjësinë direkt që kanë në mbrojtjen dhe raportimin e të gjitha formave të dhunës ndaj fëmijëve. Në këto tre muaj është promovuar roli i rëndësishëm i Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve në çdo bashki. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe në çdo qendër rezidenciale për fëmijë u promovua shërbimi i emergjencës, ku do të merret në mbrojtje të menjëhershme çdo fëmijë që ndodhet në rrezik emergjent. Janë kryer janë organizuar takime konsultative me profesionistë dhe fëmijët, në lidhje me nevojën për ndryshime ligjore dhe politika të reja për të përmirësuar sistemin e mbrojtjes së fëmijëve ligjore dhe politika të reja për të përmirësuar sistemin e mbrojtjes së fëmijëve.

### *Aktivitete të organizuara në kuadër të #UnëMbrojFëmijët:*

ASHMDF i ka dhënë rëndësi përcjelljes së **zërit të fëmijëve** pranë institucioneve dhe autoriteteve përgjegjëse për realizimin e të drejtave të fëmijëve. 482 fëmijë përfaqësues të grupeve të fëmijëve, Organizata Word Visin mbledhi në qytetet si Lezha, Shkodran, Elbasani, Librazhdi për të dhënë kontributin e tyre me rekomandime mbi mekanizmin e mbrojtjes së fëmijëve, konceptimin e Planit Kombëtar të Mobilizimit; përcjelljen e zërit të fëmijëve për pritshmërinë e tyre lidhur me të drejtat e fëmijëve si edhe detajimin e aktiviteteve.

Në prag të fillimit të kampionatit evropian, futbollistët iu bashkuan nismës sonë për të thënë publikisht **#UnëMbrojFëmijët**. Në ndeshjen që u zhvillua në Stadiumin “Qemal Stafa” Partizani dhe Tirana, ishin vetë futbollistët të cilët u bënë protagonistë dhe përcjellës të mesazhit

#UnëMbrojFëmijët. Gjithashtu dhe futbollistët e Skënderbeut dhe Terbunit veshën bluzat me logon #UnëMbrojFëmijët në ndeshjet që u zhvilluan në stadium të tjera.

Nxënësit e talentuar të shkollës “Petro Nini Luarasi”, paraqitën 13 spote aktrimi, që i kishin realizuar vetë, me mesazhe kundër të gjitha formave të shfaqjes së dhunës. Agjencia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve iu bashkua këtij aktiviteti në kuadër të Planit Kombëtar të Mobilizimit #UnëMbrojFëmijët. Takimi u zhvillua në bashkëpunim me Observatorin për të Drejtat e Fëmijëve dhe në partneritet me UNDP dhe UN Eomen Ditën Evropiane të Internetit të Sigurt .

Në kuadër të **ditës Evropiane të Internetit të Sigurt**, ASHMDF në bashkëpunim me Vodafone Albania organizuan aktivitete me prindër , mësues dhe nxënës të shkollës 9-vjeçare “Jeronin de Rada” Tiranë. Qëllimi i aktiviteti ishte prezantimi i eksperteve rreth rreziqeve dhe mënyrës se si të mbrohen fëmijët kur lundrojnë në internet dhe prezantimi i një broshurë me këshilla e cila u vjen në ndihmë të gjithë fëmijëve, prindërve, mësuesve dhe edukatorëve. Gjithashtu në kuadër të kësaj ditë është çelur fushata kombëtare e informimit dhe ndërgjegjësimit në shkolla për Sigurinë e Fëmijëve në Internet . Janë organizuar nga organizata CRCA, UNICEF Shqipëri, Linja Kombëtare e Telefonit për Fëmijë në Shqipëri – ALO 116, Rrjeti Kombëtar i të Rinjve në Shqipëri – ANYN në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe ASHMDF aktivitete informimi dhe ndërgjegjësimi për sigurinë online të fëmijëve në 70 shkollat të 12 qarqeve.

Një nga prioritet më të rëndësishme të arsimit sot në Shqipëri është parandalimi dhe **eliminimi i dhunës fizike dhe psikologjike në shkolla**, nëpërmjet mënyrave të reja të disiplinës në të gjithë sistemin arsimor 9 vjeçar publik dhe jopublik. COMBI është një program komunikimi i cili synon zgjidhjen e konflikteve në mënyrë jo të dhunshme nëpërmjet zbatimit të mënyrave të reja të disiplinimit, për të promovuar sjelljet pozitive. Në mjediset e DAR Tiranë u zhvillua trajnimi me stafet arsimore. Qëllimi i takimit ishte prezantimi i planit të punës në të cilat mbështetet zbatimi i programit COMBI dhe promovimi i Mënyrave të Reja të Disiplinës në shkolla. Ky program është një iniciativë e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit në partneritet me Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, UNICEF dhe Qendra “Fëmijët Sot”.

Në Ditën Ndërkombëtare të Ndërgjegjësimit mbi Autizmin, në bashkëpunim me Qendrën jopublike “Ndihmoni Jetën” u organizua një aktivitet me qëllim integrimin sa më të mirë të këtyre fëmijëve në shoqëri nëpërmjet rritjes dhe zhvillimit të njohurive mbi autizmin dhe shpërndarjes së informacionit mbi rëndësinë e diagnostikimit të hershëm dhe trajtimit të hershëm të fëmijëve autik. Gjithashtu dhe në bashkinë Fier u organizua aktivitet me temë **“Riciklimi është Art”** me fëmijët me aftësi të kufizuar/fëmijët autike. Aktiviteti u zhvillua në Qendrën “Horizont”, një qendër multifunksionale, për shërbime sociale për fëmijët me aftësi të kufizuar, në qytetin e Fierit. Qëllimi i aktivitetit ishte ndërgjegjësimi mbi realitetin e fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuar, dhe ne veçanti atyre autikë. Aktiviteti u organizua në formën e një ankandi me piktura dhe punime të vetë fëmijëve të qendrës, të cilat u blenë nga të ftuarit në një procedurë transparente.

**Në Ditën Ndërkombëtare të Sindromës Down**, u organizua në qytetin e Elbasanit një ekspozite me punimet e fëmijëve me Sindromën Doën. Pjesëmarrës në këtë ekspozitë ishin prindër,

përfaqësues nga institucionet dhe organizata të ndryshme. Motoja e ekspozitës së fëmijëve ishte “Unë jam unë, kam një emër” Me punimet e tyre fëmijët përcollën mesazhin që me aftësitë që ata fitojnë çdo ditë nga përkushtimi i të rriturve meritojnë të gjithë mbështetje. Ata kërkuan nga të rriturit që të pohojnë të gjithë njëzëri. Ky aktivitet u zhvillua me mbështetjen e organizatës Medpak dhe Shkollës Zëra Jete në Elbasan.

**Promovimi aplikacionit #UnëMbrojFëmijët.** Në bashkinë Durrës, ASHMDF së bashku me Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë prezantuan aplikacionin e ri [#UnëMbrojFëmijët](#), këtë mekanizëm të ri të parandalimit të dhunës ndaj fëmijëve si një nga mjetet për të raportuar dhunën ndaj fëmijëve në një anonim të plotë. Qëllimi i aplikacionit është nxitja për identifikimin e rasteve të dhunës ndaj fëmijëve dhe sigurimi i mbrojtjes së tyre, përmes referimit të rasteve në institucionet përgjegjëse. Aplikacioni është një partneritet mes UNICEF , ALO 116 111 dhe ASHMDF. Prezantimi dhe vendosja e posterave # Unë Mbroj Fëmijët drejtuar profesionistëve dhe posteri i JO Heshtjes.

Mbrojtja e fëmijëve është përgjegjësi morale dhe ligjore e të gjithë profesionistëve që punojnë për mbrojtjen e fëmijëve. Për t’iu përgjigjur situatave të abuzimit të fëmijëve nevojitet një bashkëpunim dhe bashkërendim i punës midis aktorëve përgjegjës. Për këtë arsye ASHMDF në bashkëpunim me Komisaratin nr. 2 dhe Njësinë e Mbrojtjes së Fëmijëve nr. 7 ka organizuar aktivitet informues dhe ndërgjegjësuës për fëmijët, prindërit dhe qytetarët për referimin e rasteve të fëmijëve në rrezik duke kontaktuar policinë në numrin e telefonit **112**. Qëllimi i aktivitetit ishte për rritjen e ndërgjegjësimit dhe bashkëpunimit të qytetareve për raportimin e dhunës ndaj fëmijëve. Nxitjen e bashkëpunimi ndërmjet strukturave të policisë dhe shërbimeve sociale në nivel vendor. Në aktivitet u prezantuan dy postera [#UnëMbrojFëmijët](#) dhe “Jo heshtjes!” – të cilët shpjegojnë rolin e policisë për mbrojtjen e fëmijëve dhe nevojën për bashkëpunim me Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve. Posterat u vendosën në ambientin ku ndodh pritja me qytetarët në komisarariat.

Të gjithë fëmijët kanë të drejtë të ndjehen të mbrojtur dhe të sigurt. Fëmijët kanë të drejtë të informohen dhe të ndërgjegjësohen se ku duhet të drejtohen për të reaguar ndaj abuzimit, neglizhimit dhe shfrytëzimit. Për këtë arsye ASHMDF në bashkëpunime me NJMF-të kanë organizuar takime me nxënësit dhe mësues për të prezantuar broshurën Jo Heshtjes në disa shkolla 9-vjeçare të Tiranës si në shkollën “7 Marsi”, Androkli Kostallari , “Qazim Turdiu” dhe “Gjergj Fishta”. Fëmijët u njohën edhe me mënyrat e raportimit të dhunës ndaj tyre. Tashmë jo vetëm fëmijët, por kushdo për çdo rast të dhunës ndaj fëmijëve duhet të raportojë në një nga format: Telefono në 116 111 (Alo 116), Telefono në 112 (Policia) dhe Raporto në aplikacionin [#UnëMbrojFëmijët](#).

**Autobusi i branduar #UnëMbrojFëmijët** ka udhëtuar në disa qytete të Shqipërisë si në Lushnjë, Elbasan, Shkodër, Lezhë, Vlore , Dibër dhe Durrës. Këto aktivitete janë organizuar nga Ministria e Mirëqenies Sociale të Rinisë dhe Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në bashkëpunim me bashkitë dhe organizatat partnere. Qëllimi i këtyre aktiviteti ishte ndërgjegjësimi, informimi i strukturave të pushtetit vendor, profesionistëve të mbrojtjes së fëmijëve dhe i

qytetarëve mbi rolet dhe përgjegjësitë e strukturave përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve lidhur me identifikimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës, abuzimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit të fëmijëve. Fëmijët dhe Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve ishin zëri kryesor i këtyre aktiviteteve.

Me **1 Qershor**, në ditën ndërkombëtare të fëmijëve ASHMDF në bashkëpunim me Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe parterët organizoi aktivitet më fëmijët, prindërit profesionistët, mësuesdhe Njësitet e Mbrojtjes së Fëmijëve. Qëllimi i aktivitetit ishte përmbyllja e Planit Kombëtar të Mobilizimit #UnëMbrojFëmijët (1 Mars – 1 Qershor 2016) dhe falënderimi i fëmijëve, institucioneve dhe parterëve që ju bashkuan organizimit të të gjitha aktiviteteve në kuadër të këtij plani.

#### *Mbrojtja e Fëmijëve nga trafikimi*

Në kuadër të muajit antitrafik, ASHMDF u angazhua në organizimin e aktiviteteve në bashkëpunim me Njësitet e Mbrojtjes së Fëmijëve në Bashkitë Sarandë, Fushë Krujë, Peshkopi, Kavajë dhe Koordinatorin Kombëtar Antitrafik. Këto aktivitete kishin si qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin mbi format e trafikimit të personave, veçanërisht të fëmijëve dhe mënyrat e raportimit në këto raste. Me shumë rëndësi ishte prezantimi i Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve, punonjësve të Njësive Antitrafik dhe roli mbrojtës që ka secili prej tyre ndaj fëmijëve.

#### *20 Nëntori -Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Fëmijëve*

Me rastin e 20 Nëntorit, Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Fëmijës, ASHMDF në bashkëpunim me organizatat partnere ka organizuar **javën e të drejtave të fëmijëve 14-20 Nëntor 2016**. Me qëllim pasqyrimin e aktiviteteve dhe bashkërendimin e pjesëmarrjes nga të gjithë aktorët, ASHMDF ka koordinuar aktivitetet sipas një kalendari të unifikuar. Aktivitete që janë organizuar gjatë kësaj jave kanë pasur si qëllim sensibilizimi dhe informimi i publikut të gjerë dhe të profesionistëve mbi të drejtat e fëmijëve për parandalimin e abuzimit dhe dhunës ndaj fëmijëve. Tematikat e trajtuara në këto aktivitete kanë pasur në fokus informimin ndërgjegjësimin e fëmijëve dhe profesionistëve për rolin e NJMF-së dhe të psikologut shkollor, mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi, për të drejtat e fëmijëve, prezantimi i posterave drejtuar profesionistëve, roli i komunitetit në sistemin e mbrojtjes së fëmijëve dhe integrimi i fëmijëve në konflikt me ligjin etj. Gjatë kësaj jave janë organizuar një sërë aktiviteteve ndërgjegjësuese.

#### *“Dialogun mbi Politikën e Parandalimit të Keqtrajtimit të Fëmijëve në Shqipëri”*

ASHMDF mori pjesë në “Dialogun mbi Politikën e Parandalimit të Keqtrajtimit të Fëmijëve në Shqipëri”, të organizuar nga Zyra Rajonale e OBSH-së për Evropën, Zyra e OBSH-së për Shqipërinë dhe Ministria e Shëndetësisë, në bashkëpunim me Unicef-in dhe Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Qëllimi i këtij dialogu ishte paraqitja raportit “Analiza e situatës së parandalimit të keqtrajtimit të fëmijëve në Shqipëri”, si dhe u diskutua mbi hapat për përmirësimin e politikave dhe programeve për parandalimin e keqtrajtimit të fëmijëve. Si rezultat i dialogut, përgjegjësitë e sektorit të shëndetësisë dhe objektivat lidhur me mbrojtjen e fëmijëve në sistemin shëndetësor janë integruar taashmë në Agjendën Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017-2020.

### *Inaugurimi i “Qendrës së Shërbimeve Komunitare për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara.*

Në muajin nëntor organizata Save the children në bashkëpunim me Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, ASHMDF dhe bashkinë Vlorë përruan “Qendrën e Shërbimeve Komunitare për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara”. Kjo qendër do të funksionojë në kuadër të projektit “Shërbime me bazë komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuara”, e cila financohet nga Fondacioni Margaret A. Cargill dhe do të zbatohet nga Save the Children në partneritet me shoqatën “Ndihmoni Jetën”, që do të ofrojë shërbime cilësore për fëmijët me aftësi të kufizuara. Këto shërbime do të përfshijnë mundësi për rehabilitim dhe riintegrim, ndërhyrje në fazë të hershme dhe trajtim individual për fëmijët me aftësi të kufizuara si dhe mbështetje holistike për familjet e tyre. Në inaugurim ishte pjesëmarrëse Znj. Bardhylka Kospiri Zv. Ministre e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, e cila përgëzoi këtë iniciativë të ndërmarrë me qëllim përmirësimin e aksesit dhe gjithëpërfshirës të fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshte, shkolla dhe komunitet. Fëmijët me aftësi të kufizuara duhet të gëzojnë plotësisht të drejtat edhe liritë themelore të barabarta si gjithë fëmijët e tjerë. Ato janë një kategori, e cila ka nevojë për ndërhyrje të menjëhershme dhe ofrim shërbimesh të specializuara në qendra rezidenciale dhe ditore.

### *Prezantimi i dokumenti informues “Siguria e Fëmijëve në Internet”*

ASHMDF në bashkëpunim me Linjën Kombëtare të Telefonit për Fëmijë - ALO 116 organizuan ëorkshopin ku u prezantua dhe diskutua draft dokumenti informues “Siguria e Fëmijëve në Internet”. Aktiviteti u zhvillua në kuadër të rritjes së përpjekjeve për të ofruar shërbime për fëmijë të cilët janë të ekspozuar ndaj rreziqeve online si dhe në vazhdimësi të nënshkrimit të marrëveshjes katër ministore të bashkëpunimit për sigurinë online të fëmijëve.

### *Konferenca Kombëtare “Mbrojtja e Fëmijëve nga Dhuna në Shqipëri”*

Në muajin dhjetor 2016, ASHMDF në bashkëpunim me MMSR dhe organizatat partnere UNICEF, CRCA Shqipëri, Terre des Hommes, World Vision, Save the Children, Partnerë për Fëmijët, ALO 116, QSHPLI, TLAS, Observatori për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri, Arsis, Fëmijët Sot, Shkej organizoi Konferencën Kombëtare për “Mbrojtjen e Fëmijëve nga Dhuna në Shqipëri”. Konferenca u organizua në kuadër të dy fushatave të rëndësishme të qeverisë shqiptare: #imPakti i Mirëqenies Sociale dhe #UnëMbrojFëmijët. Objektivi kryesor i konferencës ishte nxitja e dialogut kundër abuzimit ndaj fëmijëve, si dhe prezantimi i praktikave, tendencave, metodologjive dhe të dhënave; të cilat do të ndihmojnë në identifikimin e mundësive dhe mangësive në këtë fushë. Synimi i konferencës ishte të mbledhë së bashku institucionet shtetërore dhe organizatat e shoqërisë civile për të nxitur një angazhim më aktiv për promovimin dhe respektimin e të drejtave të fëmijës . Takimi ofroi rekomandime mbi mënyrën se si mund të përmirësohet parandalimi dhe reagimi ndaj abuzimit të fëmijëve

Në dhjetor 2016 ASHMDF në bashkëpunim me organizatën ARSIS dhe Save the Children organizuan në bashkitë Mat, Burrel, Gjirokastrë, Tiranë dhe Shkodër tryeza të rrumbullakët me temë: "Situata e Mbrojtjes së Fëmijëve, rekomandimet dhe planet për të ardhmen". Në këto takim

është diskutuar mbi kornizën e planit të mbrojtjes së fëmijëve për dy vitet në vijim për këto bashki dhe për vlerësimin e nevojave të mbrojtjes së fëmijëve.

### **1.3 Rritja e ndërgjegjësimit për mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge**

#### ***Konferenca “Mbrojtja e Fëmijëve nga Shfrytëzimi”***

ASHMDF në bashkëpunim me Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë , Prezencën e OSBE në Shqipëri dhe UNICEF në Shqipëri ka organizuar një konferencë të nivelit të lartë me pjesëmarrjen e ministrave palë të marrëveshjes së bashkëpunimit “Për identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge” (MMSR, MAS, MPB) dhe Kryetarët të Bashkive ku është shtrirë implementimi i planit për fëmijët në situatë rruge. Objektivi kryesor i kësaj konference është rikonfirmimi dhe angazhimi në nivel ministrash për vazhdimësinë e punës me fëmijët në situatë rruge. Gjatë takimit nga OSBE u prezantua “Analiza e vlerësimit në 7 bashkitë e përfshira, në prezantimin e vlerësimit të nevojave në këto bashki në zbatimin e planit të veprimit për fëmijët në situatë rruge ( OSBE). ASHMDF prezantoi raportin vjetor për fëmijët në situatë rruge 2015-2016 (ASHMDF – UNICEF). Gjithashtu u diskutua mbi sfidat dhe vështësitë e hasura në punën për mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge.

ASHMDF është përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të Planit të Veprimit, si dhe koordinimin e ndërhyrjeve ndër-sektoriale që përfshijnë aktorët publike dhe jopublike. Në zbatim të këtij funksioni ASHMDF në bashkëpunim me bashkitë ku është shtrirë plani për fëmijët në situatë rruge dhe organizatat partnere ka organizuar aktivitete ndërgjegjësuese, edukuese dhe informuese për fëmijët në situatë rruge.

#### ***12 Prill- Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve në Situatë rruge***

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve në Situatë Rruge, ASHMDF në bashkëpunim me Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë , Bashkinë e Tiranës dhe Rrjetin e Qendrave për Fëmijët në Situatë Rruge organizuan një aktivitet informues dhe ndërgjegjësues për fëmijët në situatë rruge. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte prezantimi i rrjetit të organizatave që ofrojnë shërbime në qendrat e tyre ditore në ndihmë të fëmijëve në situatë rruge dhe ndërgjegjësimi i qytetarëve dhe aktorëve të ndryshëm për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve nëpërmjet vetëpërfshirjes.

#### ***Prezantimi i Udhëzuesit për punën me fëmijët në situatë rruge Shkodër***

Prezantimi i Udhëzuesit për punën me fëmijët në situatë rruge Shkodër, ASHMDF me mbështetjen e OSBE prezantoi Udhëzuesin e Procedurave për identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge, një mjet pune për profesionistët në zbatim të planit të veprimit për fëmijët në situatë rruge. Plani lokal për fëmijët në situatë rruge, kërkon angazhimin e pushtetit lokal dhe të gjithë profesionistëve në Shkodër. Zbatimi i planit lokal do fillojë me punën në terren, ngritjen e skuadrave të terrenit.

### *Kampi për Fëmijët në Situatë Rruge*

ASHMDF në bashkëpunim me MMSR ,MM, Bashkinë Durrës dhe partnerë të tjerë, për herë të parë kanë organizuar kampin me fëmijët në situatë rruge në formën e një sërë aktivistesh edukuese dhe informuese. Kampi për fëmijët në situatë rruge është organizuar në Durrës duke qenë se kjo është një nga bashkitë me problematikën më të theksuar përsa i përket numrit të fëmijëve në situatë rruge. Kjo për shkak të sezonit turistik dhe lëvizjeve të familjeve rromë dhe egjiptiane nga qytetet e tjera drejt Durrësit. Qëllimi kampit ishte largimi nga rruga, argëtimi të këtyre fëmijëve në një javë, regjistrimi fëmijëve në shkollë dhe sigurimi i tyre me mjete didaktike, libra dhe çanta dhe vlerësimi i nevojave të familjeve të fëmijëve në situatë rruge dhe referimi i tyre për punësim. 30 fëmijë të identifikuar në situatë rruge qëndruan për pesë ditë në ambientet e Shtëpisë së Pushimit të Ushtrakeve në Durrës, të cilët morën shërbimet e nevojshme, u informuan për të drejtat e fëmijëve dhe u argëtuan me lojëra të ndryshme.

### *Festat duan dashuri-Aktivitet për festat e fundvitit me fëmijët në situatë rruge*

Me rastin e festave të fundvitit të ASHMDF në bashkëpunim me Alo Mik, Save the Children in Albania, Rrjetin e Qendrave Ditore për Fëmijë në Situatë Rruge , ARSIS, SHKEJ, FBSH, Qendrën ditore për fëmijë në situatë rruge, Save the children dhe kompaninë Eurolab organizuan një aktivitet festiv me fëmijët në situatë rruge. Në aktivitet morën pjesë shumë fëmijë në situatë rruge të cilët janë marrë në mbrojtje nga NJMF-të si dhe që marrin shërbime pranë qendrave ditore. Fëmijët përforcuan kërcime dhe recitime. Në fund të aktivitetit fëmijëve ju shpërndanë dhuratat të mundësuar nga organizata Alo Mik.

## **1.4 Monitorimi i situatës së të drejtave të fëmijëve**

Bazuar në ligjin aktual Nr 10347 datë “ Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve”, ASHMDF ka përgjegjësinë të realizojë mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore për çështjet që lidhen me të drejtat e fëmijëve në bashkëpunim me institucionet qendrore dhe INSTAT, në bazë të VKM Nr. 267 datë 12.04.2012 “Për llojet, mënyrën e shkëmbimit dhe të përpunimit të informacionit dhe të dhënave statistikore të kërkuara nga Agjencia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve e nga strukturat shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor”.

Agjencia mbledh të dhëna statistikore vjetore nga Ministrinë e Linjës/institucionet qendrore dhe INSTAT bazuar në formularët bashkëlidhur këtij vendimi. Treguesit janë të ndarë në 8 fusha të mëdha, në tregues demografike, të varfërisë për fëmijët, të përkujdesit social, shëndetësor, të dhunës , trafikimit, dhe mbrojtjes, e drejtësisë për të miturit, të punësimit të fëmijëve dhe treguesit e arsimimit të fëmijëve.

Për vitin 2016 ASHMDF ka dërguar shkresë zyrtare pranë këtyre institucioneve për të siguruar informacion më të dhëna statistikore. Të dhënat janë mbledhur, përpunuar dhe përditësuar në databazë. Në vazhdimësi ASHMDF po punon në përgatitjen e Vjetarit Statistikorë për Çështjet e të Drejtave të Fëmijëve për vitin 2015/2016, i cili do të përmbajë informacion statistikor zyrtar në lidhje me realizimin e të drejtave të fëmijëve.

## 1.5 Monitorimi i medias lidhur me problematikat e mbrojtjes së fëmijëve

Në përmbushje të misionit të saj, Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve monitoron rastet e fëmijëve të publikuara në media me fokus :

- Monitorimin e zbatimin e të drejtave të fëmijëve në media
- Monitorimin e problematikave të rasteve fëmijëve të publikuara në media
- Referimin e rasteve në institucionet për mbrojtjen e fëmijëve
- Monitorimin dhe reagimin në institucionet përgjegjëse për respektimin e të drejtave të fëmijëve në media.

ASHMDF harton raporte javore të monitorimit të medias. Per vitin 2016 janë hartuar 50 raporte javore të monitorimit të medias. ASHMDF ka ndjekur rastet që kanë publikuar ngjarje ku janë përfshirë fëmijët, duke referuar sipas rastit dhe problematikës në strukturat përkatëse. Për vitin 2016 janë referuar në strukturat e mbrojtjes së fëmijëve **120 raste** të publikuara nga media.

Problematikat e konstatuara mbi mosrespektimin e të drejtave të fëmijëve në media lidhen me :

- Intervistimin e fëmijëve të keqtrajtuar apo të abuzuar është bërë në shkelje flagrante të etikës gazetareske.
- Informacionet sensitive të bëra publike, që i bën fëmijët të identifikueshëm në rastet kur ato janë viktimë e një ngjarje të rëndë, ndikojnë në riviktimizimin e fëmijës dhe rehabilitimi i tyre bëhet shumë i vështirë më pas.
- Shpesh, ekspozimi i fëmijëve dhe familjeve të tyre në media, bëhet shkak për mosraportimin e abuzimit, pasi familja bën llogaritë me kostot e rënda që duhet të përballlet nëse ata denoncojnë faktin.
- Në disa raste publikimet kanë pasur një impakt negativ në përpjekjet për rehabilitimin e fëmijëve, viktimat të dhunës dhe abuzimit.

Për këto raste ASHMDF dhe MMSR ka reaguar duke bashkëpunuar me institucionet përgjegjëse për kontrollin mbi mediat. Për raste të konstatuara të shkeljes së parimeve për ruajtjen e kofidencialitetit dhe çështjeve etike lidhur me fëmijët, ASHMDF ka bashkëpunuar me Këshillin e Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) duke referuar këto raste për marrjen e masave konkrete ndaj mediave audiovizive. Për vitin 2016 ASHMDFka referuar 9 Ankesa zyrtare tek AMA dhe 20 sinjalizime tek operatorët mediatike lidhur me shkeljet e konstatuara.

Risitë e “Ligjit të ri për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve” ritheksojnë dhe përforcojnë mbrojtjen e *privacisë së fëmijëve në media* si dhe përcaktojnë mbrojtje të fëmijëve nga shfrytëzimi ekonomik si dhe *për qëllime reklamuese*. Çështjen e përdorimit të fëmijëve për efekte reklamuese, ASHMDF e ka ngritur në takime me Autoritetin e Mediave Audiovizive dhe me aktorë të tjerë të fushës së medias. ASHMDF ka theksuar që reklamat drejtuar ose përfshirjen e fëmijëve duhet të jenë në përputhje me standardet e legjislacionit dhe duhet të jenë të tilla që të shmangin çdo gjë që dëmton interesat e fëmijëve dhe mirërritjen e tyre.



Për shkak të kompleksitetit, ndjeshmërisë dhe rëndësisë që paraqet kjo çështje për të gjithë shoqërinë tonë, jo gjithnjë arrihet të menaxhohet apo rregullohet gjithçka vetëm nëpërmjet ligjit. Parimi kryesor i medias është që ajo është e lirë, prandaj zgjidhja më e mirë do të duhej të gjendej nga vetë entet mediatike. Etika nuk zgjidhet me shtrëngime financiare, siç është gjoba, duhet ndërgjegjësimi i gjithë aktorëve në këtë drejtim dhe sidomos kur behet fjalë për fëmijët. Ndaj është e rëndësishme që të krijojmë një partneritet me vetë median drejt qëllimit tonë universal: mbrojtja e fëmijëve.

## 1.6 Rritja e bashkëpunimit me partnerët

ASHMDF bazuar në funksionet e saj për bashkëpunimin me organizatat jo fitimprurëse që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre të drejtat e fëmijëve ka nënshkruar dy marrëveshje bashkëpunimi me ALO 160 dhe Foundation Together Albani. Në kuadër të përpjekjeve për të forcuar sistemin e mbrojtjes së fëmijëve, ASHMDF ka identifikuar nevojën për zhvillimin e një aplikacioni mobile me qëllim identifikimin dhe raportimin e rasteve të dhunës ndaj fëmijëve dhe sigurimin e mbrojtjes së tyre. Në këtë mënyrë ASHMDF ka nënshkruara marrëveshje bashkëpunimi me Linjën Kombëtare të Këshillimit për Fëmijë (ALO 116) me **Nr 103/1 Prot datë 21.04.2016** që ka si objektiv përmirësimin e sistemit të referimit të rasteve të fëmijëve në rrezik, përmes rritjes së bashkëpunimit ndërsektorial dhe bashkërendimit të punës ndërmjet strukturave publike dhe jo-publike.

ASHMDF së bashku me **Foundation Together Albani** kanë zhvilluar aktivitetet në lidhje me prezantimin web faqes për këshillim online për të rinjtë e Shqipërisë, [www.nukjevetem.al](http://www.nukjevetem.al). Gjatë këtij eventi u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit midis Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve dhe Fondacionit Together Albania. Me këtë marrëveshje janë të përcaktuara angazhimet dhe bashkëpunim institucional në arritjen e objektivave që synojnë ndërtimin e një sistemi funksional dhe efektiv të mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri. Qëllimi i marrëveshje është ndërgjegjësimi dhe informimi i të gjithë institucioneve, organizatave të shoqërisë civile, fëmijëve, të rinjve për shërbimin e këshillimit online [www.nukjevetem.al](http://www.nukjevetem.al) i cili ofron ndihmë falas për fëmijët dhe të rinjve, duke respektuar anonimatën e tyre si dhe referimi i rasteve të fëmijëve në rrezik që sinjalizohen nëpërmjet ëeb faqes [www.nukjevetem.al](http://www.nukjevetem.al)

## 1.7 Standartizimi dhe dixhitalizimi i sistemit të referimit të rasteve të fëmijëve në rrezik

Mungesa e një sistemi elektronik për ruajtjen, referimin dhe raportimin të të dhënave të fëmijëve në rrezik, sjell vonesa në referimin, menaxhimin dhe monitorimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për ndihmë në vend. Standartizimi dhe dixhitalizimi i sistemit të referimit, ruajtjes së të dhënave dhe monitorimit të rasteve të fëmijëve në rrezik është pjesë e detyrave të ASHMDF në planin të punës.

Në këtë kuadër kuadër Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në bashkëpunim me UNICEF dhe Terre des hommes ndërmorën një studim fizibiliteti.

Studimi synon vlerësimin e të dhënave elektronike ekzistuese të përdorura nga institucionet shtetërore dhe OJF për të vlerësuar mundësinë e ngritjes së një sistemi të vetëm, të përbashkët informacioni që do të përdoret nga të gjitha institucionet dhe ofruesit e shërbimeve.

Ky studim propozon modelin e një sistemi elektronik të integruar për menaxhimin e rastit, regjistrimin e informacionit, analizën dhe raportimin e të dhënave për mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha shërbimet publike, prej të cilave përfiton fëmija.

## **1.8 Raportimet/Aktivitetet Ndërkombëtare**

Kryetarja e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve Znj. Ina Verzivolli, përfaqëson shtetin Shqiptar në Komitetin Monitorues të Konventës, Komiteti i Lanzarotes. Komiteti Lanzarote është organ i themeluar për të monitoruar zbatimin e Konventës Lanzarote e cila në Shqipëri hyri në fuqi më 1 Korrik 2010. Çdo shtet palë i kësaj Konvente përfaqësohet nga një person përgjegjës, i cili përfaqëson shtetin respektiv në takimet periodike që zhvillon Këshilli i Europës për Konventën e Lanzarotes. Qëllimi i organizimit të këtyre takimeve është monitorimi i zbatimit dhe implementimit të Konventës së Lanzarotes, si dhe shkëmbimi i pikëpamjeve dhe praktikave të mira të zbatimit të kësaj Konvente.

Komiteti ad hoc për të Drejtat e Fëmijës (CAHENF), është ngritur nga Komiteti i Ministrave në bazë të nenit 17 të Statutit të Këshillit të Europës dhe në përputhje me Rezolutën CM / Res (2011) 24 mbi komisionet ndërqeveritare dhe organet vartëse, termat e tyre të referencës dhe metodat e punës.

Nën mbikëqyrjen e Komitetit të Ministrave, CAHENF do të udhëheqë punën ndërqeveritare në fushën e të drejtave të fëmijës. Në veçanti, CAHENF do të mbikëqyrë zbatimin e Strategjisë së Këshillit të Evropës “Për të Drejtat e Fëmijës (2016-2021)”, do të lehtësojë shkëmbimin e njohurive, praktikave të mira dhe përvojave mes shteteve anëtare si dhe do të sigurojë për shtetet anëtare, ekspertizë në zhvillimin e legjislacionit politikave, praktikave, skemave të trajnimit dhe ngritjen e vetëdijes materiale për të mbështetur zbatimin e standardeve ndërkombëtare, duke përfshirë Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijëve dhe standardet e Këshillit të Evropës për të drejtat e fëmijës në nivel kombëtar. Kryetarja e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve Znj. Ina Verzivolli është përfaqësuese e shtetit Shqiptar dhe njëkohësisht kryetare e Komitetit. Komiteti është duke hartuar standartet e Këshillit të Evropës, lidhur me mbrojtjen e fëmijëve në kontekst migrimi dhe në mënyrë të veçantë vlerësimi i moshës së fëmijëve dhe shërbimi i kujdestarisë.

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, ka përgatitur në kohë dhe me cilësi raportimet ndërkombëtare për çështjet e të drejtave të fëmijëve. Raportimet për Raport

Progresin për Kapitullin Kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore”, si dhe informacionet dhe raportimet e kërkuara në kuadër të Sesionit të 34 të KDNJ-së.

## 1.9 Ngritje e kapaciteteve të strukturave vendore për mbrojtjen e fëmijëve

ASHMDF ka zbatuar në bashkëpunim me partnerët e saj një sërë trajnimesh për ngritjen e kapaciteteve të profesionistëve në fushën e mbrojtjes së fëmijëve.

Gjatë vitit 2016, në bashkitë e Shkodrës, Korçës, Vlorës u shpërndanë trajnime për ekipet në terren dhe punonjësit e institucioneve dhe organizatave vendore për identifikimin e fëmijëve në situatë ruge ku janë trajnuar 33 profesionistë.

Gjatë periudhës prill - qershor u organizuan trajnime në 12 qarqet e vendit me teme: "Regjistrimi i fëmijëve dhe kujdesin familjar", ku morën pjesë rreth 350 profesionistë.

Grupet Teknike Multidisiplinare dhe Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve në 10 qarqet e Shqipërisë janë trajnuar për punën ndër-sektoriale për mbrojtjen e fëmijëve. Janë realizuar 10 trajnime ku janë përfshirë 262 profesionistë.

Gjithashtu, gjatë vitit 2016 janë zhvilluar trajnime me inspektorët e punës, dhe me Njësitë e Mbrojtjes së fëmijëve lidhur me inspektimin e standardeve të mbrojtjes së fëmijëve. Janë realizuar 11 trajnime në 12 qarqe të Shqipërisë ku janë përfshirë 194 profesionistë.

## KAPITULLI II

### 2.1 Të dhëna shifrore mbi rastet e fëmijëve në rrezik

ASHMDF, monitoron dhe kontrollon punën e NJMF-ve, të cilat raportojnë periodikisht, çdo tre muaj dhe një herë në vit për punën e tyre në menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje nga dhuna, abuzimi, neglizhimi apo shfrytëzimi. Mënyra e raportimit të NJMF bazohet në **VKM NR 267, datë 12.4.2012** “Për llojet dhe mënyrën e shkëmbimit e të përpunimit të informacionit dhe të dhënave statistikore të kërkuara nga ASHMDF nga strukturat shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor”, në **VKM NR 265, datë 12.04.2012** “Për krijimin dhe funksionimin e mekanizmit të bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve shtetërore përgjegjëse për referimin e rasteve të fëmijëve në rrezik, si dhe mënyrën e procedimit të tij”, dhe në **Udhëzimin Nr. 10, datë 25.02.2015** “Për mënyrat, format e bashkëpunimit dhe procedurat e ndërhyrjes në ndihmë të fëmijëve në rrezik për institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës”.

Për të standardizuar procesin e raportimit të NJMF-ve, ASHMDF ka hartuar Formularin e Raportimit Periodik për NJMF-të i cili përbëhet nga dy pjesë (ANEKSI 1):

- **Formulari A** lidhet me kërkesën për raportim për të dhëna statistikore të rasteve të menaxhuarat fëmijëve;
- **Formulari B** lidhet me kërkesën për informacion mbi mënyrën e menaxhimit të rasteve të reja, vizitave ne familje, trajnimeve dhe aktiviteteve ndërgjegjësuese.


Ky kapitull përmban informacion mbi të dhënat statistikore të rasteve të menaxhuara të fëmijëve në rrezik nga NJMF-të për vitin 2016 si edhe krahasimin me të dhënat e vitit 2015 – sipas Formularit A. Kapitulli jep një panoramë të shpërndarjes së ngarkesës së punës së NJMF. Këto raste disagregohen sipas katër niveleve të rrezikut. Ndërkohë, për rastet e reja që kanë filluar të menaxhohen në vitin 2016, informacioni është disagreguar sipas moshës, gjinisë dhe etnisë. Rastet e reja, gjithashtu janë të klasifikuara sipas aktorëve apo institucioneve të cilët i identifikojnë/referojnë rastet e fëmijëve. Ky kapitull, gjithashtu jep të dhëna në shifra ne lidhje me numrin e rasteve të fëmijëve të referuara nga NJMF-të në struktura të tjera. Së fundmi, kapitulli përmban informacion në shifra lidhur me rastet e mbyllura.

### **2.1.1 Situata e raportimit nga Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve**

Dy reformat e realizuara gjatë vitit 2015: Reforma Administrative- Territoriale dhe Reforma e Shërbimeve Sociale, prekën strukturat organizative dhe institucionale të njësive vendore, duke përfshirë këtu edhe NJMF-ve. Në vitin 2015 rezultoi se disa NJMF ishin larguar nga puna apo ishin në pritje të zëvendësimit apo ishin zëvendësuar nga punonjës të tjerë. Kjo situatë solli një rënie në numrin e raportimeve të NJMF-ve në 2015, në krahasim me vitet e mëparshme.

Aktualisht, në vitin 2016 kanë qenë aktive 221 NJMF, më të cilat ASHMDF ka patur komunikim ose bashkëpunim për çështje të mbrojtjes së fëmijëve në mënyrë sistematike ose jo. 218 prej tyre janë NJMF zyrtare, që do të thotë se ka një urdhër/vendim nga kryetarët e bashkive/njësive administrative që i emëron zyrtarisht në këtë detyrë.

#### **Tabela: Raportimi i NJMF-ve në vite**



Implementimi i këtyre reformave solli njëkohësisht dhe fuqizimin e njësive të qeverisjes vendore duke rritur kapacitetet njerëzore si edhe ofrimin e shërbimeve cilësore. Duke krahasuar me vitin 2015 vihet re një rritje e numrit të raportimeve nga NJMF, në shifrën e 141 raportime për vitin 2016. Në lidhje me cilësinë e raportimit vihet re se plotësimi i formularit A për vitin 2016 ka paraqitur po të njëjtat vështirësi për NJMF-të krahasuar me vitin 2015. Ndodh të raportohen shifra të pa rakorduara sipas indikatorëve apo raportime të pjesshme. Disa indikatorë kanë paraqitur vështirësi në kuptueshmërinë dhe në plotësimin e të dhënave. ASHMDF ka ofruar mbështetje për NJMF-të për qartësimin e të dhënave statistikore dhe plotësimin e saktë të tyre. Trajnimi i NJMF mbi menaxhimin e rasteve dhe plotësimin e saktë të formularëve të raportimit, mbetet nevojë në vazhdimësi.

#### *Profili dhe roli i NJMF-ve*

Në ligjin e ri nr. 18/2017, në nenin 49 është e përcaktuar qartë se Punonjësit e njësisë për mbrojtjen e fëmijës, përfshirë drejtuesin e saj, janë punonjës për mbrojtjen e fëmijës, me formim punonjës socialë.

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve ka mbledhur informacion përmes shkresave të raportimit periodik si dhe përmes komunikimit me telefon me NJMF-të, informacion në lidhje me rolin si NJMF dhe profilin e Punonjësit Social. Nga informacioni i mbledhur rezultoi se vetëm 41 punonjës kryejnë funksionin si PMF, ndërsa pjesa tjetër përveç detyrës si punonjës të NJMF-së kryejnë edhe detyra të tjera. Kështu, 94 punonjës kryejnë detyrën si PMF dhe administrator social, 11 punonjës kryejnë detyrën si PMF dhe specialist të dhunës në familje, 21 punonjës kryejnë detyrën si PMF dhe specialistë për personat me aftësi të kufizuara, 15 punonjës kryejnë detyrën si PMF dhe specialistë të barazisë gjinore, 1 punonjës kryen detyrën si PMF dhe


administrator i njësisë, 36 punonjës kryejnë detyrën si PMF dhe funksione të tjera.

	<b>PO</b>	<b>JO</b>	<b>Ska informacion</b>	<b>TOTALI</b>
<b>Vetëm NJMF</b>	41 (19%)	110	70	221
<b>Punonjes Social</b>	67 (30%)	88	66	221

Sigurisht, në shumë fusha, në veçanti në njësitë administrative dhe sidomos ato në zona të thella, mund të jetë e vështirë të identifikosh një person lokal që ka kualifikimet / përvojën e nevojshme. Mungesa e burimeve njerëzore të kualifikuara në mënyrë të përshtatshme, sjell një kufizim të veçantë të ofrimit të shërbimeve nga ana e NJMF-ve si edhe cilësisë së menaxhimit të rasteve. Duhet të jetë prioritet i kryetarëve të bashkive dhe njësive administrative për të emëruar punonjës të NJMF-ve persona me profil “punonjës social”.

Sipas ligjit të ri “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve” çdo njësi administrative e bashkisë e cila ka më shumë se 3000 fëmijë, ka minimalisht një punonjës për mbrojtjen e fëmijës. Ata nuk mund të angazhohen në detyra të tjera brenda njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit. Në rastet kur njësia administrative e bashkisë ka më pak se 3000 fëmijë, këtë detyrë mund ta kryejë njëri nga punonjësit e njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit, i cili ka të përcaktuar në përshkrimin e punës funksionin si punonjës për mbrojtjen e fëmijës. Bazur në risinë e këtij ligji nevojiten 170 punonjës që kryejnë detyrën vetëm si PMF dhe 251 punonjës që jo detyrimish PMF.

**Tabela: Numri i NJMF sipas numrit të rasteve të raportuara**



Në vitin 2016, 83 NJMF kanë raportuar menaxhimin e më shumë se 1 rast, numër i cili është në rritje krahasuar me 52 të tilla për vitin 2015. Kjo tregon një aktivizim më të madh të NJMF-ve për të identifikuar dhe menaxhuar raste.


10 NJMF të cilat kanë menaxhuar më shumë raste janë: Kuçovë, Elbasan, Cërrik, Fier, Shkodër, Vlorë, Njësia Bashkiake Nr. 3, Tiranë, Njësia Bashkiake Nr. 4, Tiranë, Njësia Bashkiake Nr. 7, Tiranë, Njësia Bashkiake Nr. 9, Tiranë. Pasqyrën e plotë të numrit të rasteve të menaxhuara nga çdo NJMF e gjeni në (ANEKS 2). Këto përfaqësojnë kryesisht NJMF në të cilat punonjësit kanë kohë që janë në atë pozicion dhe janë mbështetur vazhdimisht nga organizatat e shoqërisë civile si nga ana e kapaciteteve por edhe ana teknike e menaxhimit të rasteve. Kjo tregon për nevojën e mbështetjes dhe punës direkte me Njësitë për të garantuar identifikim më të mirë dhe cilësi në menaxhim të rasteve.

Edhe pse kemi një ulje të raportimeve të NJMF-ve që nuk kanë menaxhuar asnjë rast, këto shifra tregojnë se ka akoma punë për t'u bërë nga ana NJMF-ve në identifikimin e rasteve të fëmijëve në rrezik për mbrojtje por edhe në rritjen e bashkëpunimit me institucionet përgjegjëse.

## 2.1. 2 Raste në total

Gjatë vitit 2016, NJMF-të kanë menaxhuar një numër total prej 1352 raste të fëmijëve në rrezik, rreth 50 raste më pak se në vitin 2015. Prej tyre, 722 ose rreth gjysma (53 %), janë raste të reja të identitifikuara gjatë vitit 2016. Pjesa tjetër, janë raste të identifikuara gjatë viteve të mëparshme (raste të mbartura), të cilat janë ende në menaxhim.

**Tabela: Raste të menaxhuara ndër vite**



Nga tabela më sipër vihet re se nuk ka ndryshim në shifra të numrit të rasteve të menaxhuara ndër vite, por informacioni mbi mënyrën e menaxhimit të rasteve të reja të identifikuar është plotësuar nga një numër i madh i NJMF-ve duke shënuar një rritje cilësore të raportimit.


### 2.1.3 Rastet e reja sipas gjinisë, grupmoshës, etnisë

Ky seksion bën një analizë të rasteve të reja të disagreguara sipas moshës, gjinisë dhe etnisë.

Nëse krahasojmë dy vitet, vihet re se femrat janë pak më shumë në numër në krahasim me meshkujt. Në 722 rastet e reja të identifikuar për vitin 2016, 52% ishin femra dhe 48% meshkuj, duke zvogëluar paksa ndryshimin relativ mes numrit të meshkujve dhe femrave në krahasim me vitin 2015. Sipas të dhënave më sipër, përqindjet janë të ngjashme, pra kemi një trend të qëndrueshem në vite.

**Tabela: Numri i rasteve të reja sipas gjinisë**





Ndarja në tre grupmosha është bërë bazuar në ndarjen e grupmoshave në sistemin arsimor, ndarje e cila në fakt nuk jep mundësinë për të bërë një analizë të mirëfilltë. Në formularët e ardhshëm për raportim ndarja e grupmoshave do të ndryshojë duke synuar që rastet e fëmijëve të grupohen në mënyrë më të njëtrajtshme dhe të kemi një analizë më të plotë të situatës.


**Tabela : Numri i rasteve të reja sipas grupmoshës**

	0-6 vjeç	7-14 vjeç	15-18 vjeç
<b>Viti 2015</b>	<b>251 raste (34%)</b>	<b>373 raste (51%)</b>	<b>114 raste (15%)</b>
<b>Viti 2016</b>	<b>265 raste (37%)</b>	<b>385 raste (53%)</b>	<b>72 raste (10%)</b>

Siç vihet re nga tabela, pothuajse gjysma e rasteve të reja i përkasin komuniteteve Rom dhe Egjiptian, gjë që tregon se këto komunitete janë më vulnerabël dhe fëmijët shoqërohen nga situata rreziku që lidhen me një sërë shkaqesh: diskriminimi dhe marginalizimi i këtyre komuniteteve, aksesimi i kufizuar ose largësia e komuniteteve nga zonat urbane, mungesa e shërbimeve ose shërbime të pamjaftueshme, mungesa e aftësive për punësim të prindërve, mungesa e strehimit të sigurt, migrimi i brendshëm, mungesa e informacionit të prindërve, vështirësi në regjistrim në gjendjen civile, etj.

Këto rezultate janë të influencuara edhe si rezultat i punës intensive që është bërë 3 vitet e fundit për fëmijët në situatë rruge, ku pjesa më e madhe i përket këtyre komuniteteve.

**Tabela : Numri i rasteve të reja sipas përkatësisë etnike**




#### 2.1.4 Numri i rasteve të fëmijëve të identifikuar/referuar sipas aktorëve

NJMF-të raportojnë pranë Agjencisë rastet e identifikuara/ referuara të abuzimit, neglizhimit, shfrytëzim ndaj fëmijëve qoftë nga vetë ata si punonjës të NJMF si persona përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve, por edhe nga aktorë publikë dhe jo publikë apo dhe struktura të tjera përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve dhe që bashkëpunojnë ngushtësisht me NJMF.

Bazuar në Udhëzimin 4 ministror nr 10. datë 25.2.2015, aktorët nga Policia e Shtetit, Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, Drejtoritë Rajonale të Arsimit/Zyrat Arsimore dhe Shkollat, Drejtoritë e Shëndetit Publik dhe personeli i kujdesit shëndetësor si dhe ofruesit e shërbimeve për fëmijë publikë dhe privatë kanë detyrimin dhe përgjegjësinë për identifikimin dhe referimin në kohë pranë NJMF-ve të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.

**Tabela: Numri i rasteve të fëmijëve të identifikuar/referuar sipas aktorëve**



\* Totali 643 raste, është i ndryshëm nga totali i rasteve të reja të menaxhuara për 2015 (738 raste), pasi mungojnë të dhënat nga NJMF-të e bashkive Berat, Pogradec, Njësia bashkiake Nr 9 Tirane.

Numri më i madh i rasteve në dy vitet e fundit është identifikuar nga vetë NJMF-të: 37 % raste për vitin 2016 dhe 26 % raste për vitin 2015. Në vitin 2016, NJMF kanë identifikuar vetë rreth 100 raste më shumë se vitin 2015.

Një rritje në numrin e referimeve vihet re edhe nga Policia dhe OJF-të, kështu në vitin 2016 janë identifikuar 115 raste dhe 71 raste për vitin 2015 nga OJF-të. Policia ka referuar 54 raste për vitin 2016 dhe 31 raste për vitin 2015.

Gjatë vitit 2016 institucionet arsimore, shëndetësore si edhe administratorët e NE kanë referuar më pak raste krahasuar me vitin 2015. Institucionet arsimore kanë referuar 59 raste më pak krahasuar me vitin 2015.

Administratorët e NE kanë referuar 55 raste për 2016 dhe 90 raste për 2015. Institucionet shëndetësore kanë referuar 2 raste për vitin 2016 dhe 9 raste për 2015.

Edhe pse janë realizuar takime sensibilizuese me strukturat lokale, detyrimi për raportim i përcaktuar në Udhëzimin Nr. 10, datë 25.02.2015 duhet të përmirësohet duke bërë që të rriten rastet e referimeve dhe bashkëpunimi me NJMF-të nga të gjithë aktorët, sidomos nga sektorët e shëndetësisë dhe arsimit.


Si për vitin 2016 dhe 2015, janë 4 raste ku fëmijët vetë kanë referuar dhunën pranë strukturave përgjegjëse. Prindërit kanë raportuar 57 raste për vitin 2016 ndërkohë për vitin 2015 NJMF kanë raportuar 73 raste. Kontribut të rëndësishëm në identifikimin dhe referimin e rasteve kanë dhënë edhe mediat, qytetarët, shërbimet sociale rajonale dhe Shërbimi Ligjor Falas.

Gjithashtu, një pjesë e konsiderueshme e rasteve janë referuar nga skuadrat e terrenit për fëmijët në situatë rruge, pjesë e të cilave janë dhe vetë NJMF-të. Duke analizuar që në 118 rastet e referuara për vitin 2016 që shënon rritje në krahasim me 91 rastet e vitit 2015, me shumë gjasa këto raste janë në kategorinë e rasteve të identifikuar nga NJMF-të (si pjesë e skuadrave të terrenit). Në tabelën “Numri i rasteve të fëmijëve të identifikuar/referuar sipas aktorëve”, këto raportime janë paraqitur në kategorinë “Të tjerë”.

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve nënshkroi në prill 2016 marrëveshjen e bashkëpunimit me Linjën Kombëtare të Këshillimit për Fëmijë Alo 116 111. Kjo marrëveshje synon përmirësimin e sistemit të referimit të rasteve të fëmijëve në rrezik, përmes rritjes së bashkëpunimit ndërsektorial dhe bashkërendimit të punës ndërmjet strukturave publike dhe jo publike. Nga të dhënat për vitin 2016, janë referuar nga Alo 116 111 pranë Agjencisë 44 raste të fëmijëve dhe 56 raste të fëmijëve pranë NJMF-ve në të gjithë vendin. Këto raste i përkasin kategorive si: abuzim, dhunë, mungesë strehimi, mungesa e nevojave bazë, probleme në shkollë, probleme në lidhje me marrëdhëniet mes njëri tjetrit dhe marrëdhëniet familjare, probleme shëndetësore, raste të fëmijëve me nevoja të veçanta, probleme që lidhen me çështje ligjore, siguria në internet. Gjithashtu, një numër të madh rastesh zënë edhe 116 raste që janë referuar nga Alo për fëmijë në situatë rruge.

### 2.1.5 Raste të menaxhuara sipas nivelit të rrezikut

**Tabela: Numri i rasteve të menaxhuara sipas nivelit të rrezikut**



\*Tabela (Viti 2015): Totali 1275 raste, është i ndryshëm nga totali i rasteve të menaxhuara për 2015 (1403 raste), pasi në të dhënat për nivelin e rrezikut, mungojnë të dhënat nga NJMF-të e baskive Berat, Pogradec, Njësia bashkiake Nr 9 Tirane.

Sipas raportimeve rezulton se në përgjithësi NJMF-të trajtojnë raste me rrezikshmëri të ulët dhe të mesme. Bazuar në raportimet e NJMF-ve për vitin 2016, numri më i madh i rasteve kanë qenë raste me nivel të mesëm rrezikshmërie, 634 raste ose 47 % e rasteve të menaxhuara në total.

Ndërkohë për vitin 2015, numri më i madh i rasteve të trajtuara kanë qenë raste me rrezikshmëri të ulët, 570 raste.


Vërehet një ulje në trajtimin e rasteve emergjente me rreth 50 % më një vit më parë: në vitin 2016 kemi 57 raste emergjente, ndërkohë për vitin 2015 kemi 107 raste.

Mënyra e vlerësimit të nivelit të rrezikut nga NJMF-të, jo gjithmonë është sipas standardeve të kërkuara dhe në përputhje me procedurat e Udhëzimit 10. Nga komunikimet e vazhdueshme që stafi i ASHMDF-së mban me NJMF-të në ndjekje të rasteve specifike, është konstatuar se shpesh NJMF-të bazohen në perceptimin e tyre mbi nivelin e rrezikut të rastit dhe jo në kriteret e përcaktuara në legjislacion. Kjo tregon nevojën për trajnim dhe ngritje të kapaciteteve të NJMF-ve me qëllim sigurimin e zbatimit të legjislacionit me korrektësi.

### 2.1.6 Rastet e mbyllura

Gjatë vitit 2016, janë mbyllur 442 raste, që shënon një rritje të ndjeshme në krahasim me vitin 2015 (285 raste të mbyllura). Për të dyja vitet numri i rasteve të reja të identifikuara është më i madh se rastet e mbyllura. Kjo nënkupton se një numër i madh rastesh, mbarten ose vazhdojnë të menaxhohen në vitin në vazhdim.

**Tabela : Numri i rasteve të mbyllura sipas arsyes**



Numrin më të madh të rasteve si për vitin 2016 dhe për vitin 2015 e zënë rastet të cilat janë mbyllur për shkak të reduktimit të nivelit të rrezikut, në rrezik të ulët ose mungesë rreziku. Kjo

është një e dhënë pozitive, pasi tregon se janë marrë masat e duhura për të ndryshuar situatën ku ndodhet fëmija drejt uljes apo eliminimit të rrezikut.

### **2.1.7 Raste të fëmijëve të referuara nga NJMF-të në struktura të tjera**

NJMF-të raportojnë në lidhje me rastet e referuara në struktura të tjera. Këto raste drejtohen pranë NJMF-ve për zgjidhje, e cila i referon pranë institucioneve që janë përgjegjëse për zgjidhjen e tij. Këto struktura ofrojnë shërbime të specializuara për të cilat NJMF-të nuk mund t'i ofrojnë. Krahasuar me vitin 2015 ka pasur ulje të rasteve të referuara. Në vitin 2016, NJMF-të kanë referuar 192 raste pranë strukturave të tjera, në krahasim me 272 rastet e referuara në 2015. Ulja e rasteve të referuara mund të jetë si rezultat i rritjes së kapaciteteve të NJMF-ve të cilat kanë më tepër informacion për përgjegjësitë e strukturave të tjera. Bashkëpunimi i tyre në mënyrë më aktive me strukturat e tjera mund të ketë ndikuar në uljen e numrit të rasteve të referuara. Por ky është një vlerësim që ka nevojë për një analizë më të thellë, pasi aktualisht NJMF-të raportojnë vetëm në shifra mbi këtë indikator.

## KAPITULLI III - Problematikat, natyra e rrezikut dhe llojet e abuzimit

Ky kapitull lidhet me informacionin bazuar në kërkesat e **Formularit B**<sup>4</sup> dhe përmban të dhëna mbi menaxhimin e rasteve të reja për vitin 2016, problematikat e trajtuara, natyrën e rrezikut dhe llojet e abuzimit ndaj fëmijëve. NJMF-të raportojnë për menaxhimin e rasteve sipas Udhëzimit 4 ministror Nr.10, datë 25.2.2015<sup>5</sup> duke përfshirë shërbimet dhe ndërhyrjet ofruara, bazuar në problematikën e identifikuar dhe nevojat e rastit. Formulari B kërkon të dhëna vetëm për rastet e reja dhe nuk lejon të përditësohen të dhënat për rastet që janë identifikuar në periudhat e mëparshme, por që vazhdojnë të menaxhohen. Kjo duhet të kthehet në një rekomandim për vetë agjencinë për monitorimin dhe raportimin.

Bazuar në kërkesat e Formularit B, NJMF-të duhet të japin informacion lidhur me rastet që janë identifikuar gjatë periudhës së raportimit të trajtuara sipas hapave që nga procesi i identifikimit të rastit dhe masat e marra menaxhimin e tij duke u bazuar në Udhëzimin 4 ministror Nr. 10/2015.

Në vitin 2016 është shënuar përmirësim krahasuar me vitin 2015 ku nga 55% e NJMF-ve raportuese në vitin 2015, në 2016 kanë raportuar 90 NJMF, ose 63 % e NJMF-ve raportuese. Pjesa tjetër NJMF-ve raportuese, ashtu si dhe ne formularin A nuk kanë raste të reja të menaxhuara, por japin vetëm informacion për vizita në familje, takime të grupeve teknike multidisiplinare, aktivitete ndërgjegjësuere dhe takime sensibilizuese.

### 3.1 Problematikat e rasteve të menaxhuara nga Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve

Ka një sërë faktorësh të lidhur më kontekstin social në të cilin ndodhet një fëmijë dhe/ose familja e tij, të cilët kur janë të pranishëm e vendosin fëmijën në një situatë rreziku potencial. Faktorë të tillë kanë të bëjnë me dizavantazhin social të fëmijës dhe familjes, që shpesh rezulton në barriera sociale që pengojnë aksesin e fëmijës në të drejtat bazë, si e drejta për identitet, e drejta për arsim, e drejta për kujdes shëndetësor, etj.

Problematikat kryesore që raportojnë NJMF-të lidhen me situatën e vështirë ekonomike të familjeve, dhunën në familje, trafikimin, shfrytëzimin e fëmijëve, probleme me aftësinë e kufizuar, braktisjen shkollore ose mosregjistrimin.

Grafiku më poshtë përmban të dhëna në shifra të raportuara nga NjMF-të lidhur me problematikën kryesore që ka secili rast i fëmijëve të menaxhuar, duke bërë edhe krahasimin me të dhënat e vitit 2015. Duhet thënë që vetë NJMF-të evidentojnë problematikën kryesore që ka fëmija i ndodhur në situatë rreziku në Formularin A. Kjo shpesh përbën një kufizim të analizës së rastit pasi shpesh


---

<sup>4</sup>Formulari B përmban kërkesë për informacion mbi mënyrën e menaxhimit të rasteve të reja, problematikat dhe llojet e abuzimit, vizitat në familje, trajnimet dhe aktivitetet ndërgjegjësuere të organizuara nga ose me pjesëmarrjen e NJMF-ve.

<sup>5</sup>Udhëzimit 4 ministror Nr 10, datë 25.2.2015.

problematikat janë të ndërlidhura dhe ka një shkallë të lartë subjektiviteti në identifikimin e problematikës kryesore që kanë rastet.

**Tabela: Numri i rasteve të fëmijëve në ndjekje, sipas problematikave**



\* Totali 1296 raste, është i ndryshëm nga totali i rasteve të menaxhuara për 2015 (1403 raste), pasi në të dhënat për problematikat e rasteve mungojnë të dhënat nga NJMF-të e bashkive Berat, Pogradec, Njësia bashkiake Nr 9 Tirane.

Nga krahasimi i shifrave dhe informacionit mbi mënyrën e menaxhimit të rasteve rezulton që ashtu sikurse edhe në vitin 2015, edhe për vitin 2016 **problemet ekonomike të familjes dhe fëmijës** zënë vendin kryesor të problematikave të trajtuara nga NJMF-të.

Bazuar në shifrat e krahasuara për dy vitet (50% e rasteve në total për vitin 2015 dhe 43% e totalit për vitin 2016) ka një ulje të rasteve me **probleme ekonomike**, por që gjithsesi mbetet shifra më lartë për rastet e trajtuara në të dyja vitet. Idealisht rastet e familjeve të varfra nuk duhet të trajtohen në kuadër të mbrojtjes së fëmijëve, por duhen trajtuar me instrumentet e politikave të zbutjes apo eliminimit të varfërisë. Fakti që shumë NJMF janë njëkohësisht edhe administratorë socialë influencën ndjeshëm këtë të dhënë. Gjithashtu, edhe moskuptimi i duhur i konceptit të mbrojtjes së fëmijës, nga punonjësit e mbrojtjes por edhe nga aktorët që referojnë rastet, bëjnë që NJMF-të të menaxhojnë raste të varfërisë së fëmijëve.

Varfëria ekonomike lidhet me mungesën ose pamjaftueshmërinë për të siguruar të ardhura të mjaftueshme dhe kushtet bazë të jetesës për fëmijën dhe familjen. Problemet ekonomike lidhen me mungesën e strehimit për disa familje, me pamundësinë për sigurimin e veshmbathjeve dhe mjeteve të nevojshme apo pagesave të detyruara për frekuentimin nga fëmijët të institucioneve të edukimit (çerdhe, kopsht shkollë). Varfëria ekonomike në disa familje bën që prindërit të mos



ushetrojnë si duhet përgjegjësinë tyre për përkujdes prindëror dhe si pasojë fëmijët janë në situata neglizhimi, bëhen subjekt shfrytëzimi për punë apo për lypje ose vuajnë probleme shëndetësore.

Arsyet e varfërisë ekonomike janë të lidhura me një sërë faktorësh që shpesh ndërveprojnë me njeri-tjetrin: vështirësitë lidhur me punësimin e prindërve dhe mungesa e kualifikimit të tyre, migrimi i brendshëm që shpesh i përjashton familjet nga përfitimet e skemës së ndihmës ekonomike, aksesit i pamundur tek shërbimet ekzistuese për shkak të vendbanimit në zona të largëta rurale, pamjaftueshmëria e shërbimeve, etj.

*Fëmija jeton me nënën dhe babain në një banesë me qera dhe vuan prej kohësh nga astma, Kempit që merrte i është ndërprerë. Shtëpia ka lagështi dhe është e ftohtë. Prindërit kanë vështirësi në lidhje me punësimin. **Tiranë***

*Familja jeton në një banesë të afërmeve pa pagese meraje, për shkak të gjendjes ekonomike të rënduar dhe pamundësisë për të siguruar vetë mundësi banimi. **Burrel**<sup>6</sup>*

Fokus të veçantë kanë pasur në punën e tyre NJMF-të tek rastet e fëmijëve të **shfrytëzuar për punë apo lypje**. NJMF-të kanë menaxhuar **318 raste** të tilla në gjithë vendin. Këto raste përfshijnë edhe rastet e identifikuar të fëmijëve në lëvizje të cilët shpesh janë të ekspozuar ndaj formave të shfrytëzimit për punë dhe lypje nga gjatë lëvizjeve të tyre vetëm ose të shoqëruar në qytete të ndryshme të vendit.

Angazhimi i NJMF-ve nga bashki të reja në zbatim të Marrëveshjes Ndërministrorë midis MMRS, MPB, dhe MAS “Për identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge” (firmosur në 12 qershor 2015) dhe Planit Kombëtar të Veprimit për Identifikimin dhe Mbrojtjen e Fëmijëve në Situata Rruge 2015 -2017 ka rritur numrin e rasteve të menaxhuara. Në vitin 2016 funksionojnë 24 skuadra terreni për identifikimin e fëmijëve në situatë rruge në bashkitë Tiranë, Shkodër, Durrës, Elbasan, Fier, Korçë dhe Vlorë. ASHMDF ka koordinuar në bashkëpunim me aktorët lokalë shtrirjen e planit në tre bashki të reja Shkodër, Korçë, Vlorë. Në shtatë bashkitë e mësipërme janë zyrtarizuar Planet Lokale për fëmijët në situatë rruge<sup>7</sup> nga Kryetari i Bashkisë, Drejtori i Policisë, Drejtor i Zyrës së Punës, Drejtor i Drejtorisë Arsimore Rajonale. Për bashkinë Tiranë, plani është draftuar dhe pritet zyrtarizimi i tij.

<sup>6</sup>Tekstet e nga raportimet në çdo kuti janë sipas e raportimeve që kanë bërë NJMF-të e bashkive dhe njësive administrative.

<sup>7</sup><http://femijet.gov.al/al/ep-content/uploads/2016/10/Plani-i-Veprimit-per-femijet-ne-situata-rruge-bashkia-Vlore.pdf>  
<http://femijet.gov.al/al/ep-content/uploads/2016/10/Plani-i-Veprimit-per-femijet-ne-situata-rruge-bashkia-Shkoder.pdf>  
<http://femijet.gov.al/al/ep-content/uploads/2016/10/Plani-i-Veprimit-per-femijet-ne-situata-rruge-bashkia-Korce.pdf>  
<http://femijet.gov.al/al/ep-content/uploads/2017/05/Plani-i-Veprimit-Ndihm%C3%AB-p%C3%ABr-f%C3%ABmij%C3%AB-dhe-familjet-n%C3%AB-situat%C3%AB-rruge-Bashkia-Fier.pdf>  
<http://femijet.gov.al/al/ep-content/uploads/2017/05/Plani-i-Veprimit-Ndihm%C3%AB-p%C3%ABr-f%C3%ABmij%C3%AB-dhe-familjet-n%C3%AB-situat%C3%AB-rruge-Bashkia-Durr%C3%ABs.pdf>

Në vazhdimësi të punës së planeve lokale për fëmijët në situatë rruge, ASHMDF në bashkëpunim me organizatën ARSIS dhe Save the Children organizoi në bashkitë Mat, Burrel, Gjirokastrë, Tiranë dhe Shkodër, tryeza të rumbullakët me temë: "Situata e Mbrojtjes së Fëmijëve, rekomandimet dhe planet për të ardhmen". Në këto takim është diskutuar mbi kornizën e planit të mbrojtjes së fëmijëve për dy vitet në vijim për këto bashki dhe për vlerësimin e nevojave të mbrojtjes së fëmijëve.

Në shtatë bashkitë deri në fund të 2016 janë identifikuar 479 fëmijë në situatë rruge, nga të cilët 345 prej tyre janë larguar nga situata e rrugës. (72% raste të identifikuara në situatë rruge janë menaxhuar). 341 fëmijë janë regjistruar dhe frekuentojnë shkollën. Janë punësuar 103 prindër të fëmijëve në situatë rruge.

Raste të fëmijëve në situatë rruge kanë raportuar dhe NJMF të bashkive të tjera si Kukës (3 fëmijë) Gjirokastrë (2 raste).

*Dy vajzat nga e njëjta familje të moshës 8 dhe 10 vjeç kishin vite që lypnin në rruge. Vajzat nuk shkonin në shkollë dhe ka informacion që shfrytëzohen nga prindërit për lypje. Nga kontaktimi vajzat shprehen se kanë dëshirë të ndjekin shkollën. **Tiranë***

*3 fëmijë të mitur jetojnë vetëm me babain e tyre, pasi prindërit janë ndarë . Babai nuk mund të kujdesej për fëmijët dhe ata janë parë që dilnin në rrugë duke lypur. Fëmijët nuk frekuentonin shkollën. Babai i tyre nuk kujdesej për to. **Kukës***

Problematika e **dhunës në familje** është problematika e tretë për nga numri i rasteve dhe prek një numër të konsiderueshëm fëmijësh. Numri i rasteve të fëmijëve të prekur nga dhuna në familje është pothuajse i pandryshuar (nga 155 në 2015 në 150 në 2016) dhe pse me një ulje të lehtë. Rastet e dhunës në familje përfshijnë dhunë psikologjike ndaj fëmijës, dhunë fizike ndaj fëmijës nga prindi, dhunë të babait ndaj nënës dhe fëmijës, dhunë mes anëtarëve të familjes, prindërve, fëmijëve apo të afërmeve të tjerë në familje. Rastet e dhunës në familje janë të lidhura edhe me rastet kur familja është në krizë siç janë rastet kur prindërit janë të ndarë apo kanë konflikte mes anëtarëve të familjes.

Një tjetër dimension shumë i ndjeshëm dhe aktual i përplasjes së fëmijëve dhe adoleshentëve me prindërit, është përplasja e mentaliteteve mbi mënyrën e të jetuarit që çon në konflikte dhe dhunë ndaj fëmijëve, sidomos vajzave. Këto raste, janë veçanërisht lidhur me përjetimin e seksualitetit dhe krijimin e marrëdhënieve në çift. Puna për ndryshimin e mentalitetit dhe përmirësimin e komunikimit mes fëmijëve dhe prindërve mbetet një sfidë për të gjithë aktorët që përballen me problemet e adoleshentëve.

Rastet e dhunës në familje dhe ndaj fëmijëve denoncohen nga vetë fëmijët, ose nga njëri prind ndaj prindit tjetër. Rastet e dhunës ndaj nënave nga baballarët rezultojnë me pasoja psikologjike tek

fëmijët. Ende më të rënda janë pasojat kur dhe vetë fëmijët janë bërë objekt i dhunës fizike në familje.

*Fëmija jetonte me gjyshen pasi prindërit janë të divorcuar. Babai është martuar përsëri, nga martesa e dytë kanë edhe një fëmijë tjetër. Vajza ishte ankuar tek mësuesja kujdestare për prindërit që e dhunojnë psikologjikisht dhe fizikisht dhe për këtë arsye ajo iku të jetojë me gjyshen (nënë e babait). Vajza ankohej se nuk e lejojnë të komunikojë me nënën e saj. **Mat***

NJMF-të kanë ndërhyrë dhe menaxhuar 96 **raste të braktisjes shkollore** për vitin 2016 që rezultoi një shifër me madhe nga 72 raste në 2015. Gjendja e vështirë ekonomike, migrimi i brendshëm ose sezonal, rezultatet e dobëta në mësim, konflikte dhe mosmarrëveshje si me prindërit ashtu edhe me mësuesit, bëhen arsye për braktisjen e shkollës. Rastet e braktisjes shkollore janë kryesisht fëmijë të komunitetit Rom dhe Egjiptian.

NJMF-të kanë bashkëpunuar me DAR/ZA, shkollat dhe komunitetin për identifikimin e fëmijëve të paregjistruar ose që kanë braktisur shkollën. Çështja e regjistrimit ka gjetur bashkëpunimin e aktorëve, por mbetet ende sfidë braktisja e shkollës nga fëmijët gjatë vitit shkollor, si dhe referimi i rasteve nga mësuesit tek NJMF-të. Nevojitet një reagim dhe bashkëpunim më i fortë mes stafit pedagogjik dhe shërbimit psiko-social në shkolla dhe NJMF-ve për frekuentimin e shkollës nga nxënësit braktisës. Braktisja e shkollës lidhet me arsye të ndryshme siç është varfëria e familjeve, angazhimi i fëmijëve në punë të ndryshme, sidomos në bujqësi, distancat e largëta mes vendbanimit dhe shkollës, migrimi i familjeve brenda dhe jashtë vendit për arsye të ndryshme kryesisht ato ekonomike.

*4 nxënës në klasë e 8-të dhe 4 nxënës në klasë të 7-të, prej të cilëve 6 janë nga komuniteti Rom dhe 2 nga ai Egjiptian kishin braktisur shkollën. Kemi bërë takime me Drejtorinë e shkollës, kryeplakun e fshatit, me administratorin e Njesisë administrative dhe me prindërit e tyre për rikthimin në shkollë të fëmijëve. Arsyeja e braktisjes së shkollës nga nxënësit sipas prindërve është niveli i ulët ekonomik i familjeve të tyre. **Shushicë***

*“Familja prej vitesh jeton në një situatë të vështirë ekonomike. Familja bashkë me fëmijët ka ndërruar shpesh vendbanimin dhe fëmijët janë detyruar të braktisin shkollën”. **Cërrik***

### **Regjistrimi i fëmijëve të paregjistruar në gjendjen civile**

Për vitin 2016 janë trajtuar 53 raste kundrejt 35 në vitin 2015. Në rritjen e numrit të fëmijëve të regjistruar ka ndikuar dhe trajnimet në 12 qarqet e vendit gjatë vitit 2016 të realizuara nga ASHMDF në bashkëpunim me TLAS dhe SHSSH për identifikimin e fëmijëve të paregjistruar dhe njohjen me procedurat dhe udhëzimet lehtësuese për regjistrimin e tyre.

Mosregjistrimi i fëmijës në gjendjen civile e përjashton fëmijën nga aksesit në të drejtat e tjera themelore si psh, kujdes shëndetësor, arsimim dhe shërbime të tjera si dhe e ekspozon fëmijën ndaj abuzimit. NJMF-të raportojnë që kanë bërë punë identifikuese në terren për fëmijët në situatë rruge, nga ku raportohet dhe numri më i lartë i rasteve të fëmijëve të paregjistruar.

Fëmijët e lindur jashtë vendit, veçanërisht të lindur nga prindër pa kurorë janë rastet që hasin më shumë vështirësi për regjistrim, për arsye të proceduarave që duhen ndjekur, mungesës së dokumentacionit si dhe shpenzimeve financiare për sigurimin e tij. Kjo ndodh sepse zgjidhja e çështjeve ligjore që lidhen me regjistrimin e lindjes së fëmijës është shpesh e lidhur me zgjidhjen e një sërë problemesh të tjera ligjore të ndërmjetme që kanë kosto të papërballueshme për xhepat e familjeve të prekura nga fenomeni i mos regjistrimit të lindjeve. Zgjidhje e rasteve shoqërohet jo vetëm me koston e asistencës ligjore të avokatit por edhe me një sërë shpenzimesh gjyqësore si ato të psikologut, noterit, përkthyesit, laboratorit për analizën shkencore të ADN-së, legalizimit të dokumenteve në konsullata, etj.

Për këto raste që janë të shumta në numër, NJMF-të kanë pasur bashkëpunim me Organizatën TLAS dhe Observatorin për të Drejtat e Fëmijëve të financuara nga donatorë si UNICEF, UNDP, CRD, Save the Children dhe Terre Des Hommes.

Puna për kapërcimin e barrierave të sipër përmendura mbeten një sfidë jo vetëm për NJMF-të por dhe të strukturave të tjera vendore.

*Fëmija është në klasën e parë, por është i paregjistruar në gjendjen civile. Prindërit janë të divorcuar, vajza ka lindur në Greqi dhe nëna aktualisht jeton në Greqi, ndërsa babai dhe vajza janë kthyer dhe jetojnë në fshatin Perondi. **Kuçovë***

*Dy prindërit bashkëjetojnë pa martesë dhe kanë një fëmijë të paregjistruar dhe rrjedhimisht i pavaksinuar. Familja jeton në kushte të vështira ekonomike dhe e kanë të pamundur të ndjekin procedurat e regjistrimit. **Konispol***

Një problematikë tjetër e trajtuar nga NJMF-të është **aftësia e prindërve për tu kujdesur për fëmijën**. NJMF-të raportojnë që kanë menaxhuar **49 raste** të fëmijëve që për arsye të ndryshme u mungon kujdesi prindëror. Arsyet janë mungesë e kapaciteteve prindërore për përkujdesje, për arsye shëndetësore të prindërve apo të fëmijëve, për shkak të vdekjes së njërit ose të dy prindërve, probleme të mardhënieve në çift, braktisjes nga prindërit të fëmijëve, divorceve problemeve me alkoolin, etj. Në varësi të rastit dhe të nivelit të rrezikut për fëmijët të cilët, për arsyet e mësipërme mbeten ose rrezikojnë të mbeten pa kujdes prindëror NJMF-të kanë marrë në mbrojtje fëmijët duke i vendosur ata në përkujdesje alternative duke mundësuar që disa prej tyre të sistemohen në institucione, disa pranë të afërmeve të familjeve biologjike, si gjyshërve ose të afërm të tjerë. Roli i NJMF-ve për këto raste është shume i rëndësishëm për vlerësimin e rrezikut dhe masat që do të merren për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative. Në bazë të raportimeve për menaxhimin e këtyre rasteve është identifikuar nevoja urgjente për programe të aftësimin prindëror që parashikohen në ligjin e ri “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve”.

*Fëmija 22 muajsh nga fshati X braktistet nga nëna. I ati kërkon ndihmë që fëmija të transferohet në një ambient tjetër për shkak të kushteve ekonomike, në të cilat jeton vajza.*

**Maqellarë**

*Nëna kërkon të braktisë fëmijën pas problemeve me bashkëjetuesin i cili është edhe babai i fëmijës. Jetojnë në kushte të vështira ekonomike. Nena nuk mund të punojë pasi nuk kishte ku të linte vajzën pasi nuk ka besim t'ia leje babait, i cili sipas nënës ka probleme me alkoolin.*

**Kuçovë**

NJMF-të raportojnë që kanë menaxhuar **20 raste** të fëmijëve me **probleme shëndetësore**. Rastet e menaxhuara lidhen me probleme të kequshqyerjes, anoreksinë, mungesën e vaksinimit, sëmundjet kronike, helmime, raste të sëmundjeve terminale, epilepsitë. Gjithashtu janë trajtuar raste të fëmijëve me probleme të shëndetit mendor siç janë sjelljet antisociale dhe agresive, mungesë përqendrimi dhe hiperaktivitet. Rastet janë identifikuar dhe referuar tek NJMF-të nga shkollat, policia. NJMF kanë ndërhyrë me vizita në familje, kanë bashkëpunuar me aktorë nga shëndetësia, punonjës socialë nga qendrat komunitare për ofrimin e shërbimit psikologjik lidhur më këto raste.

*Vajza ka probleme të mosushqyerjes, pasi vajza ka patur problem me dhëmballët, nga kjo ka pasuar anoreksi tërheqje dhe apati. NJMF ka bërë vizita në familje dhe ka ofruar mbështetje psikologjike për vajzën duke e orientuar familjarët për ofrimin e shërbimit shëndetësor dentar të specializuar. **Ura Vajguore***

*13-vjeçari vuan nga probleme të shëndetit mendor dhe epilepsi. Fëmija shfaq sjellje agresive, largohet nga banesa. Sjelljet e tij janë bërë problem për bashkëjetuesin e nënës i cili e ka dëbuar djalin nga banesa për shkak të mosmarrëveshjeve, grindjeve që kishin prej kohësh midis tyre. **Gjirokastër***

NJMF i kanë kushtuar vëmendje edhe punës me **fëmijët me aftësi të kufizuar** duke orientuar familjet për sigurimin e pagesës së paaftësisë për fëmijët, por dhe në sigurimin e aksesit në shërbime dhe ndjekjen e arsimit të detyrueshëm për këta fëmijë. Janë trajtuar 30 raste të tilla në qendra të specializuara për këtë shërbim që mbetët në të njëjtat shifra me 2015(29 raste). Mbetet sfida shtrirja e shërbimeve në të gjitha bashkitë e vendit. Është evidentuar që në shumë njësi administrative por dhe bashki mungojnë mësuesit mbështetës që të mund të lehtësojnë ndjekjen e procesit mësimor për fëmijët me Aftësi të Kufizuar. Format e aftësisë së kufizuar tek fëmijët janë rastet me sindromë Doën dhe të autizmit.

*Djali 13 vjeç është me aftësi të kufizuara dhe trajtohet me temp. Për të kujdeset nëna nëna e tij. Familja është në kushte të vështira ekonomike. Për të ofruar mbështetje për familjen në bashkëpunim me OJF, janë siguruar ndihma ushqimore, veshmbathje për fëmijën. **Tiranë***

*Fëmija vuan nga autizmi. Fëmija ndjek shkollën, por mësuesja ka ngritur shqetësimin që nuk mund të përballojnë nevojat e fëmijës në klasë, panjë mësuese ndihmëse. Mësimi zhvillohet në klasa kolektive me nxënës të moshave të ndryshme. **Finiq***

Nga raportimet evidentohet që shpesh NJMF-të i raportojnë rastet e fëmijëve me aftësi të kufizuar si probleme të shëndetit mendor tek fëmijët.

*Fëmija vuan nga çrregullime të shëndetit mendor dhe largohet shpesh nga shtëpia. Babai e ka të pamundur të përkujdeset për të. **Durrës***

*Fëmije vuan nga probleme të shëndetit mendor dhe shfaq shenja agresiviteti. Edhe pse asistuar rasti nga NJMF, ai ka nevojë për trajtim të specializuar në një qendër. **Tiranë***

Problematika e **fëmijëve të trafikuar apo viktime të mundshme të trafikut** megjithëse ka raportim shifrash nuk ka informacion se çfarë ka bërë NJMF-të për menaxhimin e këtyre rasteve.

Nga krahasimi i të dhënave në shifra në dy vitet e fundit vërehet një ndryshim i papërfillshëm. Këto dy problematika gjithashtu nuk reflektohen tek rastet e reja të menaxhuara sipas formularit B.

Një tjetër problematikë që raportohet, ndonëse në shifrat të pakëta është ajo e fëmijëve nën moshën e përgjegjësisë penale që **kryejnë vepra penale**. NJMF-të raportojnë që ka vështirësi në menaxhimin e këtyre rasteve, pasi mungojnë qendrat rehabilituese dhe shërbimet e specializuara për këto raste të fëmijëve.

Përveç problematikave të sipër përmendura ka dhe raste që trajtohen për më shumë se një problematikë. Kryesisht varfëria e familjes i bën fëmijët vulnerabël ndaj formave të ndryshme të rrezikut dhe multiplikon problematikën e tjera duke thelluar njëkohësisht edhe impaktin e tyre tek fëmija dhe familja.

Në këto raste problematikën bashkëveprojnë duke sjellë pasoja tek fëmijët. Rastet kur varfëria thëllon problemet e prindërimit apo nxit dhunën në familje hasen shpesh. Problemet ekonomike bëhen shkak për të tjera problematika si e mosregjistrimit në gjendje civile, frekuentimit të shkollës, apo marrjes së shërbimit shëndetësor të duhur sipas nevojës.

*“Fëmija i gjashtë erdhi në një familje me pamundësi ekonomike. Vështirësia për të ushqyer fëmijën po sillte probleme në shëndetin e fëmijës. Mjekja patologe konstatoi shenja dehidratimi dhe një peshë shumë të vogël të fëmijës.” **Berat***

*“Nga pesë fëmijët e një familje, tre janë të regjistruar, dy janë të paregjistruar. Gjendja ekonomike e tyre është shumë e dobët sepse askush nuk është i punësuar. Situata është përkeqësuar tani që babai ndodhet në burg”. **Dibër***

*“Fëmija është diagnozuar me prapambetje mendore të lehtë. Babai i tij është larguar me njerikën jashtë shtetit dhe nuk tregon asnjë interes për të, ai ka jetuar për një periudhë të*

*shkurtër me gjyshërit. Po duke qenë se gjendja e tyre ekonomike është shumë e dobët ata e kanë dërguar në Elbasan tek qendra “Tjetër Vizion” dhe me pas është transferuar në një qendër në Durrës ku ka qëndruar për 4 vjet. Por fëmija është kthyer tek gjyshërit pasi nuk donte të qëndronte në qendër”. **Belsh***


### 3.2 Abuzimi i fëmijëve

Ky kapitull përmban informacion mbi rastet e trajtuara dhe llojin e abuzimit ndaj fëmijëve. Sipas(OBSH, 1999) “Abuzimi apo keqtrajtimi i fëmijëve përfshin të gjitha format e keqtrajtimit fizik dhe/ose emocional, abuzimin seksual, lënien pas dore apo trajtimin neglizhues, shfrytëzimin e fëmijës për qëllime përfitimi apo çdo lloj tjetër që shkakton dëmtim aktual apo të mundshëm të shëndetit, mbijetesës, zhvillimit apo dinjitetit në kontekstin e një marrëdhënie përgjegjësie, besimi apo pushteti.” Ky indikator përfshin katër lloj abuzimesh:

- Abuzimi fizik;
- Abuzimi seksual;
- Abuzimi psikologjik;
- Neglizhimi

**Bazuar në të dhënat e raportuara**, nga 1352 raste të ndjekura në total nga NJMF-të gjatë vitit 2016, 936 raste ose 69% e rasteve, kanë qenë fëmijë të cilët kanë pësuar të paktën një nga llojet e abuzimit, ndërkohë në vitin 2015 kanë qenë 555 raste ose 40% e tyre. Numri i rasteve të abuzimit krahasuar mes dy viteve është afërsisht i dyfishuar. Bazuar në të dhënat e NJMF-ve, lidhur me katër llojet e abuzimit, numri më i madh i rasteve të menaxhuara janë raste të **neglizhimit** të fëmijëve i cili gjithashtu është dyfishuar për vitin 2016 (619 raste) krahasur me vitin 2015 (352 raste). Dyfishimi i rasteve të neglizhimit përkon me rritjen e numrit të rasteve të abuzimit në total. Takimet ndërgjegjësuere në kuadër të planit kombëtar të mobilizimit #unë mbroj fëmijët, gjatë periudhës mars-qershor 2016 ka ndikuar në identifikimin e më shumë më tepër rasteve të fëmijëve të neglizhuar në të gjithë vendin. Përfshirja e shumë aktorëve lokalë, përveç NJMF-ve në takimet dhe aktivitetet ndërgjegjësuere ka dhënë rezultat për rritjen e rasteve të referuara dhe identifikuar nga të gjithë aktorët.

**Grafiku: Numri i rasteve të fëmijëve në ndjekje sipas llojit të abuzimit**



\* Në të dhënat për vitin 2015 mungojnë të dhënat nga NJMF-të e bashkive Berat, Pogradec, Njësia bashkiake Nr 9 Tirane.

## Neglizhimi

Neglizhim quhet mungesa kronike dhe serioze e kujdesit dhe vëmendjes, me ose pa qëllim, nga prindërit/kujdestarët ndaj nevojave të fëmijës për strehë, siguri, mbikëqyrje, ushqim, shëndet dhe arsim, që sjell dëmtim fizik dhe/apo emocional të fëmijës. **Neglizhimi i fëmijëve** nga prindërit ose kujdestarët vazhdon të mbetet forma më e përhapur e dhunës me të cilën përballen fëmijët në Shqipëri, si e tillë është dhe më lehtësisht e identifikueshme nga aktorë të ndryshëm të mbrojtjes së fëmijëve.

Rastet e raportuara të neglizhimit nga NJMF-të për vitin 2016 janë raste të mungesës së kujdesit për ushqim, për strehë, për vëmendje. Zakonisht fëmijët e neglizhuar janë nga familje të varfra, por jo vetëm. Ka dhe raste edhe pse të pakta në numër kur edhe pse nuk mungojnë kushtet ekonomike, fëmijës i mungon kujdesi i duhur dhe siguria.

*“Fëmija nuk ka shkuar asnjëherë në kopsht. Fëmijës nuk i plotësohen nevojat bazë për ushqime, veshmbathje dhe kujdes. Fëmija nuk ka mjete didaktike, shkollore, libra dhe pse është në moshë për arsim”. **Tiranë***

*“Banesa në të cilën jetonin ishte në kushte normale jetese për fëmijët. Nëna kujdeset gjatë ditës por gjatë natës, fëmijët jetonin të vetëm në banesë. Nëna punonte deri në orët e vona të natës dhe fëmijët ishin pa kujdes dhe siguri deri sa të kthehej e ëma nga puna”. **Tiranë***



Mungesa e informacionit, ose rastet kur prindërit janë me prapambetje mendore nuk zotërojnë aftësitë e përshtatshme prindërore për t'u kujdesur për fëmijët e tyre. Si rrjedhojë fëmijët mund të neglizhohen për vaksinimin, mirëushqyerjen, higjenën. Ndërhyrjet e NJMF-ve në këto raste kanë konsistuar në shoqërimin e prindërve për vaksinimin e fëmijëve, në këshillimin për nënat lidhur me mënyrën e ushqyerjes së fëmijëve, ofrim të paketave ushqimore dhe sanitare për fëmijët dhe familjet. NJMF-të raportojnë që rastet e konstatuara të neglizhimit janë në monitorimin e vazhdueshëm dhe me aktorë të tjerë veçanërisht nga sektori i shëndetësisë.

## Abuzimi psikologjik

Është një tjetër formë e abuzimit i renditur në shifra të larta të rasteve të raportuara në total (20 % e rasteve). Kjo formë e abuzimit është më pak e dukshme se rastet e dhunës fizike apo abuzimit seksual, por mund të shkaktojë dëmtime afatgjata të shëndetit mendor të fëmijës. Ky lloj abuzimi përfshin sjelljet degraduese, frikësuese, poshtëruese dhe refuzuese ndaj fëmijës, dhe mund të shoqërore abuzimin fizik ose seksual. Abuzimet zakonisht kryhen nga të afërm të familjes ose persona të tjerë që kanë për detyrë të kujdesen për fëmijën.

Nga të dhënat në shifra vërehet që edhe rastet e abuzimit psikologjik kanë një rritje të konsiderueshme në 2016 (nga 106 në 2015 në 186 në 2016).

Raste të abuzimit psikologjik lidhen me shkaqe të ndryshme siç janë mentaliteti i familjeve për lidhjet mes të rinjve, rastet e dhunës dhe konfliktet mes prindërve, dramet në familje shkaktojnë abuzim psikologjik tek fëmijët duke i kthyer prindërit në abuzues ndaj fëmijëve.

Raste të abuzimit psikologjik janë identifikuar nga psikologu i shkollës, mësuesit, vetë fëmijët.

*“Dy fëmijë nga një familje kanë qenë prezent gjatë konflikteve të vazhdueshme të dy ish bashkëshortëve, prindërve të tyre duke përjetuar situata stresante dhe tronditje psikologjike”.*

### **Bërzhitë**

*“Vajza 16 vjeçare është ndjerë e dhunuar psikologjikisht nga familjarët e saj, E tronditur vajza paraqitet në polici, duke treguar se abuzohej psikologjikisht për shkak të një lidhje dashurie me një djalë në fshatin fqinj”.* **Thumanë**

*“Fëmijët pas divorcit jetonin me gjyshen dhe gjyshin. Fëmijët janë të traumatizuar nga dhuna e shkaktuar nga babai në fëmijërinë e tyre, ai ka goditur shpesh nënën në sy të fëmijëve”.* **Libohovë**

## Abuzimi fizik

Në këtë kategori përfshihet çdo tentativë, dëmtim fizik apo plagosje e fëmijës, të cilat nuk janë aksidentale dhe që synojnë të shkaktojë dhimbje ose shqetësim, sado të lehta qofshin këto. Në abuzimin fizik përfshihen forma të tilla, si: rrahja, shkundja/shytyja me forcë, djegia, goditja (shuplakë ose shkelm), pickimi, çjerrja, kafshimi, qortimi i rreptë, detyrimi me forcë për të kryer një veprim, përdorimi i lëndëve që shkaktojnë dhimbje ose shqetësim.

Rastet e abuzimit fizik të trajtuara nga NJMF-të zënë rreth 11 % e rasteve të rasteve në total dhe kanë pësuar rritje si shifër për vitin 2016. Abuzimi fizik ndaj fëmijëve ndodh kryesisht në familje dhe kryhet kryesisht nga babai, nga vëllai më i madh por ka dhe raste kur është nëna e fëmijës. Rastet kur dhuna ushtrohet nga babai ndaj nënës dhe ndaj fëmijëve, abuzimi fizik shkakton dhe pasoja psikologjike tek fëmijët.

Rastet e abuzimit fizik janë referuar pranë NJMF-së nga policia, shërbimi social, dhe psikologia e shkollës. Në varësi të rastit, NJMF ka ndërhyrë bashkë me aktorët e nevojshëm për menaxhimin e rastit. Ka raste kur nëna bashkë me fëmijën largohet nga shtëpia dhe vendoset tek të afërm nga dhuna e bashkëshortit pa denoncuar rastin. Në këto raste ka qenë NJMF e cila ka këshilluar, mbështetur dhe ka shoqëruar nënën me zyrën e koordinatores për Dhunës në Familje për ndjekjen procedurave për strehim të nënës dhe fëmijës në një nga qendrat për mbrojtjen nga dhuna në familje. Në shumicën e rasteve të dhunës ndaj nënave dhe fëmijëve, por dhe të dhunës ndaj vetë fëmijëve, aktorët vendorë kanë bashkëpunuar për sigurimin e Urdhrit të Mbrojtjes dhe sigurimin e një ambienti të sigurt për nënën dhe fëmijët e abuzuar, ku roli i NJMF në shumicën e rasteve është iniciues. Në qendrat e trajtimit të rasteve të dhunës në familje është ofruar shërbim i specializuar për fëmijët e abuzuar fizikisht dhe shpesh NJMF-të raportojnë për monitorimin e fëmijës në këto qendra, por jo në të gjitha rastet, NJMF-të raportojnë që kanë një bashkëpunim të mirë me shkollat, mësues dhe psikologë për monitorimin e rasteve të fëmijëve të abuzuar fizikisht në familje apo dhe jashtë saj.

Nisur nga rastet e raportuara nga NJMF-të, vërehet që abuzimi fizik i fëmijëve ndërvepron me faktorë të ndryshëm ku evidentë janë varfëria, problemet në çift të prindërve, divorcet. Menaxhimi i këtyre rasteve kërkon angazhim të shumëfishtë, por ka raste kur ndërhyrja fokusohet tek mbështetja ekonomike dhe sistemimi i familjes, duke mos trajtuar në kohë pasojat që mund të ketë tek fëmija abuzimi fizik.

*Fëmija është abuzuar fizikisht nga babai. Familja me pesë fëmijë ndodhet në vështirësi ekonomike. Nga vlerësimi që iu bë rastit, u morën masa për sistemimin e vajzës në një qendër rezidenciale, ku po merr dhe trajtimin psikologjik dhe emocional. **Gramsh***

*Babai ka ushtruar dhunë ndaj nënës dhe fëmijës, prindërit janë të divorcuar. Nëna është person me nevoja te veçanta. Të dy, nëna me fëmijën jetojnë te shtëpia e vëllait të saj, ky i fundit kujdeset për djalin. **Kuçovë***

## Abuzimi seksual

Rastet e abuzimit seksual ndaj fëmijëve mbeten në të njëjtat shifra si në vitin 2015 dhe zënë rreth 3% të rasteve në total.

Rastet e abuzimit seksual, lidhen kryesisht me ngacmime apo abuzime të fëmijëve nga persona të afërm në familje, njerëz në rrethin e besimit, si gjyshi, njerku, kushëriri. Fëmijët e abuzuar janë të moshave të ndryshme, që nga 6 vjeç deri në 15 vjeç. Rastet janë identifikuar nga të afërm të

fëmijëve, nga vetë fëmijët, nga media dhe janë identifikuar kryesisht nga ASHMDF përmes monitorimit sistematik të medieve dhe më pas janë referuar pranë NJMF-ve. ASHMDF ka referuar 42 raste abuzimi seksual nga mediat, por në raportimet e NJMF-ve rezulton një shifër më e vogël e raportuar prej NJMF-ve (27 raste). Nga ndjekja e rasteve të referuar NJMF-ve, rezulton që kjo mospërputhje mund të shpjegohet me arsyet që jo të gjitha rastet e referuara nga media rezultojnë të vërteta, disa nga rastet nuk raportohen nga NJMF-të me argumentin që vepra është kryer me dëshirë nga persona mbi 14 vjeç, disa nga rastet pas kontaktimit me NJMF-të kanë deklaruar që nuk kanë pasur abuzim.

Për rastet e denoncuara ka pasur reagim të menjëhershëm dhe bashkëpunim ndërmjet strukturave vendore. Mbështetja është ofruar si për fëmijën ashtu dhe për familjen. Mbështetja ka konsistuar në vlerësimin e menjëhershëm të rastit dhe denoncimin në polici. Për disa nga rastet kur abuzimi ka ndodhur nga familjarë dhe fëmijët janë ende në rrezik abuzimi janë marrë masa për vendosjen e fëmijës në qendër emergjence. Kryesisht rastet janë referuar në polici nga prindërit dhe vetë fëmijët, të afërm të familjes, shërbimet sociale, psikologu i shkollës.

Mbështetja e psikologut për rastet e abuzimit seksual është siguruar nga nivel vendor, por ka pasur dhe raste kur është ofruar dhe me ndihmën e organizatave partnere, pasi në disa baski të vendit nuk është e mundur të sigurohet shërbim i specializuar psikologjik.

Familjet janë treguar bashkëpunuese për ofrimin e shërbimit psikologjik për fëmijët, por ka edhe raste që familjarët nuk kanë pranuar ndihmën dhe ndërhyrjen e NJMF-ve, por kanë preferuar të sigurojnë ofrimin e trajtimit psikologjik privatisht.

NJMF-të raportojnë që rastet e abuzimeve seksuale janë denoncuar, por ato nuk kanë informacion për masën e dënimit të abuzuesit. Në disa raste, ka informacion se familjarët kanë tërhequr denoncimin dhe abuzuesit janë të lirë, ose janë larguar jashtë vendit. NJMF-të raportojnë që rastet janë zgjidhur me “marrëveshje” mes palëve, duke synuar që fëmijët të kalojnë traumën pa pasoja.

*Vajza 15 vjeç është abuzuar seksualisht nga babai i saj. Nëna e vajzës kishte vdekur dhe vajza jetonte me njerikën dhe babain. Ka qenë njerka e vajzës që pas rrëfimit të vajzës, ka denoncuar në polici babin abuzues. Për rastin u bë në mënyre të menjëhershme ndërhyrja nga NJMF-ja që kontaktoi vajzën dhe siguroi ofrimin e shërbimit psikologjik të nevojshëm. Vajza aktualisht frekuenton shkollën dhe është me rezultate të mira në mësimet. **Dibër***

*Dy fëmijë të mitur, një vajzë një djalë, 10 dhe 9 vjeç respektivisht, kanë përjetuar një tentativë për abuzim seksual nga i njëjti person mbi 50 vjeç. Rasti u mbyll në marrëveshje me familjarët me kusht që të mos përsëriten sjellje të pahijshme. Personi abuzues u largua përkohësisht jashtë shtetit. **Himarë***

## KAPITULLI IV

### 4.1 Ndërhyrjet, shërbimet e ofruara për mbrojtjen e fëmijëve.

Në kuadër të procesit të menaxhimit të rasteve, NJMF-të raportojnë që bashkëpunojnë me aktorët në nivel vendor për të ofruar shërbime dhe ndërhyrjet për fëmijët, duke koordinuar aktorët e nevojshëm sipas rastit dhe situatës së rrezikut për fëmijën. Shërbimet e ofruara janë në varësi të nivelit të rrezikut dhe të problematikës së paraqitur. NJMF duhet të hartojë një Plan Individual Mbrojtjeje, i cili përmban hapat që do të ndërmerren nga aktorët e ndryshëm, për të përmbushur nevojat e fëmijës dhe për të ulur nivelet e rrezikut. Në bazë të nevojave, plani duhet të përcaktojë shërbimet, ofruesit e këtyre shërbimeve si dhe afatet kohore për ofrimin e tyre.

Në bashkitë e mëdha si Tiranë, Elbasan, Lushnjë, Korçë, Berat, Shkodër, Kavajë, Sarandë, Vlorë, NJMF-të raportojnë që kanë një bashkëpunim të mirë dhe ofrojnë shërbime për rastet e fëmijëve në nevojë. Por gjithashtu vërehet që dhe bashki më të vogla, NJMF-të janë aktive dhe në bashkëpunim me aktorët vendorë kanë gjetur zgjidhje për rastet, siç janë bashkitë si Cërrik, Kuçovë, Maliq, Himarë.

Për fëmijët që janë viktimë ose në rrezik të abuzimit, dhunës, shfrytëzimit dhe neglizhimit, nuk ka shërbime të mjaftueshme dhe të specializuara, prandaj fëmijët nga zonat larg qendrës së bashkisë, e kanë të vështirë të kenë aksesueshmëri edhe në ato pak shërbime të mundshme.

Vështirësi kanë pasur NJMF-të për rastet e **abuzimit seksual**, pasi në bashkitë e vogla mungon prezenca e një psikologu të specializuar, dhe ky shërbim është mbuluar kryesisht me ndihmën e psikologu shkollor të cilët duhet thënë nuk kanë specializimin e përshtatshëm për trajtimin e rasteve të tilla dhe shërbimi që ato mund të ofrojnë është një këshillim të përgjithshëm. Në disa raste sipas mundësisë shërbimi psikologjik është ofruar nga të psikologë nga organizatat. ARSIS, Save the Children dhe Terre des Homme.

Për rastet e fëmijëve që janë nën **moshën për përgjegjësi penale**, por që kryejnë vepra penale, janë hasur gjithashtu vështirësi në trajtimin e tyre, pasi mungojnë shërbimet e rehabilitimit në të gjitha bashkitë – si dhe për shkak të vakumit ligjor. Kodi Penal ka parashikuar vetëm masa edukuese për fëmijët të cilët përjashtohen nga dënimi duke mos parashikuar akte nënligjore për zbatimin në praktikë të këtyre masave.

**Për rastet emergjente**, MMSR ka nxjerrë Udhëzimin nr.14. dt. 10-05-2016 “Për ofrimin e shërbimit të emergjencës në institucionet e përkujdesit shoqëror të financuara nga fondet e buxhetit të shtetit që ofrojnë shërbime të përkujdesit rezidencial për fëmijët në nevojë”. Ky udhëzim bën të mundur që fëmijët në situatë emergjente të mund të priten për 72 orë pranë këtyre institucioneve të cilat bashkërendojnë punën me NJMF-të. Kjo e fundit brenda 48 orësh nga marrja e njoftimit, njofton zyrtarisht institucionin mbi vendimin e grupit teknik multidisiplinar. Në bashkitë ku është shtrirë Plani i Veprimit për fëmijët në situatë rruge, shërbimi i emergjencës aplikohet në institucionet rezidenciale publike që gjenden në këto bashki. Deri në fund të muajit qershor 2016 dhomat e emergjencës janë ngritur pranë institucioneve rezidenciale në bashkitë Tiranë, Shkodër,

Durrës, Vlorë. Në bashkinë Korçë është në proces ngritja e dhomës së emergjencës në bashkëpunim me organizatën World Vision.

Shërbimet e ofruara për fëmijët variojnë në varësi të situatës dhe problematikave. Në veçanti për familjet e prekura nga varfëria që përshton shumicën e familjeve të fëmijëve që janë menaxhuar nga NJMF-të, qëllimi i menaxhimit të rastit është fuqizimi i familjes. Shërbimet për fëmijët dhe familjet ofrohen të integruara, por duke patur në fokus specifikat dhe nevojat e fëmijëve.

**Shërbimet për fëmijët** në bashkitë e mëdha arrijnë të përmbushin një numër të madh nevojash krahasuar me bashkitë e vogla apo me njësitë administrative larg qendrave të mëdha.

Shpesh koordinimi për adresimin e nevojave kanë kërkuar dhe ndërhyrjen e strukturave të larta të bashkisë deri në ndërhyrjen e kryetarit të bashkisë. Për raste të bëra publike në media, ASHMDF ka referuar tek NJMF-të dhe ka asistuar dhe ofruar mbështetje teknike për menaxhimin e rastit sipas procedurave të mbrojtjes së fëmijëve.

Përfshirja në skemën e ndihmës ekonomike për familjen është nga shërbimet bazë të ofruara: NJMF-të informojnë dhe ndihmojnë familjet për plotësimin e dokumentacionit dhe ndjekjen e procedurave. Gjithashtu, NJMF-të referojnë familjarët e fëmijës për punësimin dhe formim profesional, por ende ka vështirësi në këto proces, pasi ka refuzim për punën e ofruar ose braktisje të saj. Për familjet që kanë nevojë për strehim janë ofruar bonuse për pagesa qiraje të banesës ose banesa sociale. Bashkia Tiranë për vitin 2016 ka ofruar qira banese për periudha 6 mujore deri në 1 vit si dhe ofrim të banesave sociale. Bashkitë e tjera të mëdha janë në proces diskutimi për aplikimin e kësaj bonusi për familjet në nevojë në strehim.

Në zbatim të planeve të mbrojtjes, OJF-të të cilat janë pjesë e këtij plani ofrojnë mbështetje me paketa ushqimore, mbështetje për pagesa të përkohshme të qirave të banesave, mbështetje dhe këshillim psikologjik për fëmijët dhe familjet, asistencë ligjore dhe rast nevojë etj.

Për **fëmijët me Aftësi të kufizuar** ka pasur rritje të ofrimit të shërbimeve nga Qendrat ditore të specializuara kombëtare, në bashkitë Fier, Elbasan, Pogradec, Durrës, Vlorë, Librazhd, Gramsh, Skrapar, Poliçan të mbështetura nga organizatat partnere si Save the Children, Eorld Vision dhe Medpak. NJMF-të në bashkëpunim me shërbimet sociale në bashki mundësojnë lehtësim për përfitimin e e pagesës së paaftësisë, për fëmijën me Aftësi të Kufizuar dhe referim te tek shërbimet përkatëse.

Për raste të fëmijëve të dhunuar dhe abuzuar NJMF bashkëpunon me psikologë shkollorë për ofrimin e shërbimit psikologjik, këshillim dhe mbështetje psiko-sociale për fëmijët. Në rastet kur, nga vlerësimi i parë, kërkohet një shërbim psikologjik i specializuar, ASHMDF ndërmjetëson, koordinon me OJF-të për ofrimin e këtij shërbimi. që veçanërisht për rastet e abuzimit seksual të fëmijëve ASHMDF ka ndërmjetësuar për ekspertizë teknike të specializuar me OJF-të, pasi ky shërbim mungon nga stukturat shtetërore. Për fëmijët që kanë nevojë për **përkujdesje alternative, pasi u mungon kujdesi prindëror**, NJMF-të kanë ndjekur procedurat për kujdestarinë në familjet me lidhje gjaku si alternativa e parë për sistemim të fëmijëve. Kur nuk ka qenë e mundur kjo në bashkëpunim me shërbimin social në bashki dhe atë rajonal është mundësuar ofrimi i shërbimit në Institucionet e Përkujdesit Shoqëror.

Lidhur me **rastet emergjente raportohet** që janë marrë masa për largimin e fëmijëve në situatë emergjente nga familja dhe sistemimin në një ambient të sigurt. Ka pasur raste kur vetë fëmijët ose të shoqëruar nga nëna me urdhër mbrojtje kanë kërkuar ndihmë për një strehë të sigurt për shkak të dhunës së ushtruar nga babai.

Kryesisht fëmijët në situata emergjente janë sistemuar në institucionet rezidenciale publike dhe private dhe në strehëza për dhunën në familje. Një pjesë e madhe e këtyre rasteve janë fëmijë në situatë rruge. Ka raste që fëmijët janë sistemuar tek të afërm familjarë që kanë marrë kujdestarinë e tyre ose në familje kujdestare. Sipas raportimeve të NJMF-ve për vitin 2016, janë 52 fëmijë që janë trajtuar me shërbime në qendrat e emergjencës në gjithë vendin.

### **Shërbimet për fëmijët në situatë rruge**

Në zbatim të Marrëveshjes e Bashkëpunimit për Fëmijët në Situata Rruge, Nr.Prot. 3430 datë 12.06.2015 mes Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Planit të Veprimit janë ofruar shërbime për fuqizimin e familjeve dhe fëmijëve në situatë rruge.

Disa prej shërbimeve ofruar familjeve me fëmijë në situatë rruge konsistojnë në: • Regjistrimin e çdo fëmije që identifikohet i paregjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile duke plotësuar dokumentacionin e nevojshëm dhe duke ndjekur procedurat e duhura. • Vaksininim e çdo fëmije që identifikohet i pa vaksinuar. • Vizita mjekësore në institucione shëndetësore për fëmijët dhe mbështetje me medikamente • Regjistrim në shkolla dhe kopshte • Punësim i prindërve • Referim për frekuentim në qendra ditore për fëmijë • Vendosje në institucion të përkujdesit social në rast të interesit më të lartë të fëmijës etj.

**Për fëmijët në situatë rruge** regjistrimi në shkolla, kopshte, çerdhe, strehimi i familjeve dhe punësimi i prindërve të tyre, mbeten sfidat më të mëdha. Kjo ndodh pasi kuotat në shkolla, kopshte, çerdhe janë të limituara, fëmijët që regjistrohen shpesh janë braktisës. Referimi për regjistrim në qendrat ditore që ofrojnë shërbime për fëmijë në situatë rruge dhe frekuentimi i qendrave nga fëmijët ka rezultuar pozitiv në procesin e menaxhimit të rasteve.

Me qëllim vlerësimet e nevojave për fëmijët si dhe evidentimin e shërbimeve ekzistuese dhe të atyre që mungojnë në 7 bashkitë ku po zbatohet plani i veprimit për fëmijët në situatë rruge: Tiranë, Durrës, Fier, Elbasan, Korçë, Vlorë dhe Shkodër janë organizuar takime me fokus grupe me aktorë në nivel vendor Në përfundim të procesit është hartuar Raporti “Analiza e vlerësimit në 7 bashkitë e cila do t’i shërbejë përmirësimit të ofrimit të shërbimeve në këto bashki dhe hartimit të planeve të ndërhyrjes.

Familjet dhe fëmijët janë mbështetur me pako ushqimore, veshmbathje dhe pako higjeno-sanitare, shërbime mjekësore dhe lehtësim procedurash juridike/administrative. Në bashkëpunim me Drejtoritë Arsimore Rajonale është bërë regjistrimi në shkolla dhe po monitorohet frekuentimi i tyre në shkollë. Në këtë proces NJMF kanë bashkëpunuar me organizatat për fëmijët si TLAS dhe

ARSIS, FBSH, SHKEJ, Save the Children, Terre des Homme. Organizatat partnere kanë ofruar dhe pajisje didaktike mësimore për fëmijët.

Për disa bashki, siç është bashkia Shkodër, mbetet sfida numri i madh i fëmijëve në situatë rruge dhe shërbimet e shumëfishta që kanë nevojë këta fëmijë dhe familjet e tyre. Shembulli më pozitiv vjen nga bashkia Elbasan ku janë ofruar shërbime në 100% të rasteve të identifikuar. Gjithashtu në bashkinë Tiranë pavarësisht numrit të lartë të fëmijëve në situatë rruge, janë menaxhuar 211 raste. Në rastet e shfrytëzimit flagrant të fëmijëve me qëllim përfitim ekonomik janë bërë 24 kallëzime penale ndaj këtyre personave.

Lidhur me rastet e trafikimit të fëmijëve ASHMDF, nuk është pjesë e Autoritetit Përgjegjës dhe e Proceduarave Standarde të Veprimit. Megjithatë për rastet e identifikuara të trafikimit ka bashkëpunuar me strukturuat antitrafik dhe me Autoritetin Përgjegjës duke referuar rastet tek NJMF-të.

#### 4.2 Funkionimi i grupit teknik multidisiplinar (GTM)

Në këtë kapitull jepet informacion mbi funksionimin e Grupit Teknik Multidisiplinar (GTM) në lidhje me funksionimin dhe pjesëmarrjen e aktorëve, në mbledhjet e GTM, nëse kanë qenë aktivë në mbledhjet e GTM, periodicitetin e takimeve dhe problematikat e shfaqura.

Sipas Udhëzimit 10.dt.25.02.2015, anëtarët e GTM duhet të bashkëpunojnë me NJMF-të në takimet e GTM duke marrë përgjegjësitë për mbrojtjen e fëmijëve, në bazë të detyrimit ligjor të përcaktuar në ligj dhe në udhëzimin e posaçëm për bashkëpunimin e aktorëve. Aktorët pjesëmarrës ftohen nga NJMF-të në takime në varësi të rastit të rrezikut.

Nga raportimet vërehet se NJMF-të dhe aktorët vendorë nuk zbatojnë përgjegjësinë për bashkëpunim për menaxhimin e rasteve. NJMF-të raportojnë që disa prej tyre nuk e njohin këtë përgjegjësi, ose nuk e vlerësojnë siç duhet. Raportohet që nga 141 NJMF që kanë raportuar, 55 prej tyre ose rreth 40% të tyre raportojnë që e kanë mbledhur GTM. Frekuenca e mbledhjes së GTM është në varësi të rasteve dhe ndryshon nga një njësi në tjetrën. Ka pasur raste kur një NJMF ka mbledhur 25 GTM në vit, ashtu sikurse ka NJMF që raportojnë që nuk kanë mbledhur asnjë GTM. Arsytet janë se nuk kanë pasur raste për menaxhim, por dhe raste kur nuk ka pasur gatishmëri nga aktorët vendorë.

Aktorët kryesorë që bashkëpunojnë janë mësues dhe psikologë shkollorë, përfaqësues të policisë, shërbimit social shtetëror, përfaqësues të OJF dhe qendrave ditore, psikologë, administratorë socialë. Në këto raste raportohet që ka pasur bashkëpunim dhe marrje të përgjegjësisë institucionale të secilit aktor.

*“GTM ka funksionuar për menaxhimin e çdo rasti. Janë trajtuar: mundësi punësimi, strehimi, akomodimi i fëmijëve në çerdhe/kopsht/shkolle. Aktorët aktive:Psikologe klinikë, punonjës organizate, punonjës te policisë, mësues”. Njësia administrative nr 7 Tiranë*

*“Grupi në përgjithësi ka qenë bashkëpunues si për marrjen pjesë në takimet për ndërtimin e*

*planeve ashtu edhe në zbatimin e planeve dhe detyrave të lëna gjatë takimeve.” **Petrele***

*Takime e GTM janë realizuar në ambientet e baskisë në prani të përfaqësuesve të Policisë Rrethit Mat, mjekes së lagjes, NJMF. Rasti që u diskutua ishte për mbështeten e një familjeje me disa fëmijë në kushte ekstreme varfërie. Shërbimet që u ofruan për rastin janë: regjistrim për përfitim të ndihmës ekonomike. Familjes iu lidh kontratë e qiraje tek noteri. Vajza ndjek shkollën 9vjecare, djali ndjek parashkollorin. **Mat***

Por ka dhe NJMF të cilat raportojnë që nuk kanë pasur nevojë të mbledhin GTM, pasi nuk kanë identifikuar raste të fëmijëve në nevojë.

*“Ende nuk është organizuar një grup multidisiplinar për arsye se niveli I rrezikut të rasteve të identifikuar nuk është i lartë, rastet që janë trajtuar janë me probleme ekonomike, por pa shfaqur problematika që lidhen me fëmijët” **Shëngjergj***

NJMF- të raportojnë që grupet teknike multidisiplinare mbledhen për menaxhimin e rasteve emergjente dhe atyre në rrezik të mesëm dhe të lartë. Në disa bashki realizohen takime periodike për trajtimin e të gjitha rasteve si dhe prezantimin e rasteve të reja për menaxhim.

Për rastet në rrezik të ulët NJMF-të siç janë NJMF-të e bashkive Fier, Durrës, Elbasan raportohet që realizohen takime me aktorët e nevojshëm për zgjidhjen e rastit, për të menaxhuar dhe ngarkesën e madhe të rasteve që kanë NJMF-të. Disa nga rastet e dhunës në familje ose rastet e lidhura me varfërinë janë zgjidhur nga NJMF-të nëpërmjet takimeve me policinë dhe psikologët shkollorë ose me shërbimin social rajonal.

Përfshirja e prindërve në GTM për menaxhimin e rasteve është një proces i rëndësishëm për zbatimin e planit të mbrojtjes për fëmijët, konsultimin për marrjen e vendimeve për fëmijët. Jo në të gjithë rastet, prindërit tregohen bashkëpunues. Edhe pse mendohet mund të jene prindër me probleme në çift , të divorcuar ose proces divorci, neglizhues, apo të dhunshëm, përfshirja e tyre në këtë proces është në interes të fëmijës dhe të prindit gjithashtu, i cili arrin të njohë më qartë përgjegjësitë prindërore.

*“Janë hasur problematika gjatë menaxhimit të rastit, pasi ka prindër që neglizhojnë pjesëmarrjen në takimet e GTM duke e veshitur zgjidhjen e problemit”. **Vorë***

Rol të rëndësishëm kanë patur OJF-të si për referimin e rasteve pranë NJMF-ve por dhe në ofrimin e asistencës, trajnimit të tyre për mënyrën e organizimit të GTM. OJF-të janë bërë pjesë aktive e grupeve duke asistuar NJMF-të e reja në koordinimin e GTM, në sugjerimet zgjidhjen e



rastit, në ndarjen me anëtarët grupeve dhe marrjen e përgjegjësiave për detyrat në GTM. Përfaqësuesit e OJF-ve janë treguar gjithmonë të gatshëm, për të mbështetur NJMF-të gjatë vështirësive dhe sfidave që hasin për zgjidhjen e rasteve, duke i shoqëruar në vizita në familje, duke ofruar ekspertizë teknike, duke mbështetur financiarisht nevojat e rasteve. Forcimi i rolit të NJMF-ve mbetet një domosdoshmëri për kryerjen e detyrës së saj funksionale koordinuese.

Ka dhe raste kur NJM-të raportojnë për mbledhjen e GTM pa specifikuar pjesëmarrjen e aktorëve dhe problematikat dhe rastet që kanë menaxhuar.

Takimet për rivlerësimin e rasteve raportohen në pak bashki. Takimet e rivlerësimit bëhen me qëllim të monitorimit të rasteve deri në fuqizimin e familjeve.

*“Qëllim i takimeve në vazhdimësi është monitorimi i procesit të fuqizimit të familjes dhe ndryshimet e saj”. Tiranë , njësia administrative nr 11*

Edhe në rastet e rivlerësimit nuk ritakohen të njëjtët aktorë të mëparshëm që kanë dijeni për rastin. Është e rëndësishme që ndjekja e rasteve në vazhdimësi të bëhet nga i njëjti person apo personat e përshtatshëm,.

*“Jo të gjithë aktoret i janë përgjigjur kërkesës së NJMF-së si dhe nuk kanë zbatuar zbatuar detyrat e lëna në takimet e GTM , pasi nuk janë aktorët e përshtatshëm. marra përsipër në takim”. Njësia bashkiake nr 9, Tiranë*

### 4.3 Vizitat në familje

Ky kapitull lidhet me përshkrimin dhe numrin e vizitave të kryera në familje nga NJMF. Vizitat në familje kryhen nga NJMF me qëllim identifikimin e rasteve të reja, vlerësimin e fëmijës dhe familjes si dhe monitorimin e rasteve që janë në menaxhim, etj. Për vitin 2016 janë realizuar 11740 vizita në familje, nga ku 686 vizita janë realizuar nga NJMF-të e bashkisë Tiranë.

Viti 2015	Viti 2016
1955 vizita	1740 vizita
1403 raste të menaxhuara.	1352 raste të menaxhuara

Gjatë vitit 2016 NJMF-të kanë realizuar 1740 vizita në familje, që janë më pak se vitin e kaluar edhe pse raportohet një numër më i lartë rastesh të menaxhuara. Rritja e punës identifikuese në terren, sidomos për rastet e shfrytëzimit ekonomik të fëmijëve, ka rritur numrin e rasteve të menaxhuara, por siç duket nga shifrat, nuk është reflektuar kjo edhe me numrin e vizitave në familje. Vazhdimësia e monitorimit të rasteve, nëpërmjet vizitave në familje, është një hap i

domosdoshëm për të siguruar se fëmijët dhe/ose familja po marrin shërbimin e nevojshëm sipas planit deri në uljen e nivelit të rrezikut për fëmijën dhe familjen.

Qëllimi i vizitave ka qenë njohja me gjendjen ekonomiko - sociale të familjeve, evidentimi i problematikave të fëmijëve, vlerësimi i rasteve, intervistat në familje, monitorimi e rasteve që janë në menaxhimi dhe ndjekjen e planit të mbrojtjes. Për arsye të sigurisë dhe etikës, por dhe në varësi të rastit, NJMF shoqërohen edhe nga aktorë të tjerë në vizitat në familje siç janë administratorët socialë, policia, nga kryepelqtë e fshatrave, psikologë, përfaqësues të Zyrës së Përmbartimit në varësi të rasteve.

NJMF-të e njësive administrative të Tiranës kanë realizuar vizita të shpeshta për rastet e fëmijëve në situatë rruge. Vlerësimi i nevojave të familjeve Rome dhe Egjiptiane, njohja me vështirësitë janë evidentuar nga NJMF-të përmes vizitave. Vizitat bëhen gjithashtu për rastet e kujdestarisë, para dhe pas sistemimit të fëmijëve në institucione. Në periudhën e regjistrimit në shkollë, janë realizuar vizita lidhur me fëmijët e paregjistruar në shkollë.

NJMF-të shprehin që përmes vizitave krijohet besueshmëri tek familjarët, rritet motivimi i tyre për t'u impenjuar në zgjidhjen e problematikave duke i bërë dhe familjet pjesëmarrëse në planin e mbrojtjes.

Periodiciteti i vizitave bëhet në varësi të rastit. Shpesh raportohet vizita që bëhet në familje nga administratorët socialë, por që nuk është mirëfilli për identifikimin edhe menaxhimin e fëmijëve, por për vlerësim të situatës social ekonomike të familjeve dhe të fëmijëve.

Në disa zona të largëta, në njësitë e thella administrative, NJMF-të nuk kanë mundësi të bëjnë vizitat në familje për shkak të mungësës së mjeteve të transportit, ose pamundësisë për tu shoqëruar nga një person tjetër në distancat e largëta. Problem ka pasur edhe në raste kur familjet janë treguar refuzuese ndaj vizitës së NJMF duke përbërë dhe rrezik në ndonjë rast për sigurinë e NJMF-së.

## **4.5 Problematikat e raportimit dhe punës për menaxhimin e rasteve**

### ***4.5.1 Problematika të konstatuara në menaxhimin e rasteve***

Me shtrirjen e re territoriale të bashkive është i rëndësishëm trajnimi i aktorëve të rinj të grupit multidisiplinar, të cilët nuk kanë qenë pjesë e GTM më parë. Vetë NJMF-të e njësive të reja administrative bazë të raportimeve duket që nuk e kanë të qartë rolin dhe funksionimin e GTM.

Mënyra e menaxhimit të rasteve nga NJMF-të me përvojë bën diferencë e cila reflektohet edhe mënyrën e raportimit . NJMF-të e bashkisë Tiranë të cilat kanë marrë trajnime të vazhdueshme që prej kohës së krijimit reflektojnë që janë përfshirë në procesin e menaxhimit në përputhje dhe në zbatim të legjislacionit.

Por shumica e NJMF-ve bëjnë një raportim joefektiv, si në shifra ashtu dhe në informacion. Raportimi për mënyrën e menaxhimit të rasteve bëhet i pjesshëm. Kjo krijon vështirësi për analizimin e të dhënave nga ASHMDF dhe pasqyrimin e situatës reale të mbrojtjes së fëmijëve.

Për disa nga rastet, edhe pse niveli i rrezikut kërkon takim të GTM, NJMF-të raportojnë që menaxhimi i rastit është realizuar me takime të drejtpërdrejta me një aktor të vetëm si psh. me shërbimin social ose policinë, apo me një përfaqësues të OJF.

Disa NJMF raportojnë mbledhjen e GTM, edhe në mungesë të rasteve për menaxhim, me qëllim për të forcuar bashkëpunimin ndërmjet aktorëve përgjegjës për rastet e mbrojtjes së fëmijëve në nivel vendor.

Në rastet e raportuara të mbledhjes së GTM, konstatohet që jo të gjithë aktorët bashkëpunojnë sipas protokollit, duke mos zbatuar afatet dhe përgjegjësitë për detyrat e ngarkuara dhe raportimin për zbatimin e tyre pranë NJMF-ve, që dëshmon për nevojën për përmirësim të bashkëpunimit mes aktorëve.

Bashkëpunimi mes aktorëve për raste raste abuzimi, dhune, apo që kanë nevojë për ndihmë të bëra publike në media, paraqet një tjetër problematikë. NJMF-të kanë hasur vështirësi për identifikimin e këtyre rasteve, pasi informacioni në media është kofidencial. Bashkëpunimi i NJMF me policinë, shëndetësinë, apo arsimin në këto raste ka nevojë të përmirësohet duke kryer në kohë referimin e ndërsjelltë mes institucioneve dhe NJMF-ve.

Një nga problematikat kryesore mbetet mungesa e shërbimeve të përshtatshme në territor, duke u bërë pengesë në vendimmarrjen gjatë takimeve. Lidhur me këtë shpesh kërkohet ndihma e organizatave partnere. Mungesa e shërbimit të emergjencës në disa bashki raportohet si pengesë për menaxhimin e rasteve emergjente.

Ndërhyrjet për rastet e familjeve me fëmijë të cilat janë në vështirësi ekonomike, shpesh njoftohen duke raportuar si shërbim vetëm futjen e familjes në skemën e ndihmës ekonomike, pa bërë vlerësimin për çdo fëmijë dhe plan përkatës të mbrojtjes, mbledhjen e GTM etj.

Vështirësi hasen dhe në sistemimin e fëmijëve në institucione rezidenciale për shkak të procedurave dhe mungesës së dokumentacionit, i cili kërkon kohë dhe ndjekje nga NJMF, ndërkohë që gjendja e fëmijës kërkon zgjidhje të shpejtë.

Nga përshkrimi i informacionit për rastet e emergjente del që disa NJMF kanë perceptim jo të qartë për rastet emergjente, pasi raportojnë si të tillë, raste të fëmijëve në situatë rruge ose në pamundësi ekonomike të një familje të varfër.

#### ***4.5.2 Problematikat në plotësimin e raportimit të formularit***

Mënyra e raportimit periodik pranë ASHMDF kërkohet e detajuar në dy formularë: Formulari A (me të dhëna statistikore mbi llojet e abuzimit dhe problematikat e fëmijëve të marrë në mbrojtje) dhe Formulari B (informacion mbi problematikat e trajtuara dhe mënyrën e menaxhimit të rasteve të reja).

Sipas raportimeve nga shumicën e NJMF-ve ende vërehet vështirësi në plotësimin e formularëve. Shifrat në formularin A raportohen të paakorduara me indikatorët përkatës ose pjesërisht të rakorduar. Ka pasur një tendencë në rritje për plotësimin edhe të formularit B (formulari narrativ) të cilit një vit më parë nuk i kushtohej vëmendje.

Plotësimi i formularit A ka paraqitur vështirësi për NJMF-të. Ndodh të raportohen shifra të paakorduara sipas indikatorëve apo raportime të pjesshme. Disa indikatorë kanë paraqitur vështirësi në kuptueshmërinë dhe në plotësimin e të dhënave. ASHMDF ka ofruar mbështetje për NJMF-të për qartësimin e të dhënave statistikore dhe plotësimin e saktë të tyre. Trajnimi i NJMF mbi menaxhimin e rasteve dhe plotësimin e saktë të formularëve të raportimit, mbetet nevojë në vazhdimësi.

Një pjesë e NJMF-ve që janë edhe administratorë socialë dhe kryejnë edhe detyrën e NJMF, apo edhe detyra të tjera shtesë, ato pasqyrojnë në formularë, numrin e fëmijëve, familjet e të cilëve trajtohen me NE apo pagesave të tjera të mbrojtjes sociale. Kështu, shpesh herë shifrat e raportuara mund të mos lidhen me punën që duhet të kryejë NJMF për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në rrezik.

Disa NJMF edhe pse kanë bërë menaxhime rasti dhe vizita në familje i raportojnë vizitat përciptas pa i plotësuar rubrikat përkatëse, duke nënkuptuar që nuk i jepet rëndësia e duhur konceptit të vizitës në familje.

Ka dhe raste kur NJM-të raportojnë për mbledhjen e GTM pa specifikuar pjesëmarrjen e aktorëve dhe problematikat dhe rastet që kanë menaxhuar. Takimet për rivlerësimin e rasteve raportohen në pak bashki.

Ka raste kur raportohet një situatë rreziku për fëmijën dhe nga ana tjetër nuk raportohen masat e marra për rastin, mbledhja e GTM, plani i mbrojtjes për fëmijët.

Ka dhe raste që raportohen vetëm problematikat e identifikuar pa informacionin përkatës mbi përshkrimin, menaxhimin dhe procedurat e ndjekura për rastin. Ose jepen hollësi të tejzgjatuara, detaje të panevojshme për rastin, por pa përshkruar qartë tek hapat e ndërmarrë dhe zbatimin e protokollit, afatet dhe angazhimin e secilit aktor.

## ANEKS 1 – Formularët e raportimit

### A- Formulari i raportimit periodik të Njësive për Mbrojtjen e Fëmijës (të dhëna në shifra)

Bashkia/ Njësia administrative _____		Viti 2016
<b>1</b>	<b>Numri i rasteve të menaxhuara në total</b>	
<b>2</b>	<b>Numri i rasteve të reja</b>	
	<i>Rastet e reja specifikojini sipas:</i>	
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Grupmoshës:</b> 0-6 vjeç</li> </ul>	
	7-14 vjeç	
	15-18 vjeç	
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Gjinisë :</b> Femra</li> </ul>	
	Meshkuj	
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Etnisë</b> Rom</li> </ul>	
	Egjiptian	
	Të tjerë	
	<i>Popullsi maxhoritare (Shqiptare)</i>	
<b>3</b>	<b>Numri i rasteve të fëmijëve të identifikuar/referuar nga: (referohuni Nr. të rasteve të reja)</b>	
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• NJMF</li> </ul>	
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Policia</li> </ul>	
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• OJF</li> </ul>	
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Prindi</li> </ul>	
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Fëmija</li> </ul>	
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Institucione arsimore</li> </ul>	
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Institucione shëndetësore</li> </ul>	
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Administratori i NE</li> </ul>	
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të tjerë (specifiko) _____</li> </ul>	
<b>4</b>	<b>Numri rasteve të mbyllura</b>	
	<i>Rastet e mbyllyra specifikojini sipas arsyes:</i>	
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• fëmija është mbi 18 vjeç</li> </ul>	
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• është reduktuar niveli i rrezikut, në rrezik të ulët/mungesë rreziku</li> </ul>	
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• fëmija jashtë rrezikut dhe nuk ka më gjasa të kthehet përpara se të mbushë 18 vjeç</li> </ul>	
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• fëmija vdes</li> </ul>	
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• fëmija është transferuar në një vendbanim tjetër</li> </ul>	
<b>5</b>	<b>Numri i rasteve të menaxhuara sipas nivelit të rrezikut: (referohuni Nr. të rasteve në total)</b>	
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• i ulët</li> </ul>	
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• i mesëm</li> </ul>	
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• i lartë</li> </ul>	
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Emergjent</li> </ul>	

	<i>(Fëmijë në situatë emergjente konsiderohet, fëmija i cili nëse lihet në rrethanat aktuale, pa asnjë ndërhyrje mbrojtëse, mund të vdesë, të dëmtohet ose plagoset rëndë, apo të jetë pre e keqtrajtimit të konsideruara vepër penale, në bazë të VKM NR 265, datë 12.04.2012)</i>	
<b>6</b>	<b>Numri i vizitave të kryera në familje</b>	
<b>7</b>	<b>Numri total i fëmijëve të referuar nga Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve në struktura të tjera</b> <i>(“Rastet e referuara” nënkuptojnë ato raste të cilat kanë marrë zgjidhje të menjëhershme pasi NJMF i ka referuar në institucione të tjera dhe nuk ka më nevojë që rasti të menaxhohet nga NJMF)</i>	
<b>8</b>	<b>Numri i rasteve të fëmijëve në ndjekje sipas problematikave (referohuni Nr. të rasteve në total)</b> <i>(Fëmija mund të ketë më tepër se një problematikë, klasifikojeni sipas problematikës kryesore)</i>	
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• dhunë në familje</li> <li>• trafikim</li> <li>• shfrytëzim fëmijë ( përfshihen fëmijët në situatë rruge dhe fëmijët që punojnë në format më të këqija të punës)</li> </ul>	
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• probleme ekonomike</li> <li>• aftësi e kufizuar</li> <li>• mosregjistrim</li> <li>• braktisje shkollore</li> <li>• Tjetër (specifiko) _____</li> </ul>	
<b>9</b>	<b>Numri i rasteve të fëmijëve në ndjekje sipas llojit të abuzimit (referohuni Nr. të rasteve në total)</b> <i>(Fëmija mund të ketë më tepër se një abuzim, klasifikojeni sipas abuzimit kryesor)</i>	
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• abuzim fizik</li> <li>• abuzim seksual</li> <li>• abuzim psikologjik</li> <li>• neglizhim</li> <li>• Tjetër (specifiko) _____</li> </ul>	

**B-Formulari i raportimit periodik të Njësive për Mbrojtjen e Fëmijës**  
**Viti 2016 (Janar-Dhjetor) (informacion narrativ)**

Bashkia/Njësia administrative \_\_\_\_\_

**1. Për çdo rast të ri për tremujorin Korrik-Shtator 2016, përshkruani problematikën dhe masat e marra** *(shtoni faqe të tjera nëse është e nevojshme)*

**Viti 2016 (Janar-Dhjetor 2016)**

**2. Përshkruan vizitat në familje, qëllimin dhe periodicitetin e tyre** *(shtoni faqe të tjera nëse është e nevojshme)*

**Viti 2016 (Janar-Dhjetor 2016)**

**3. Përshkruani funksionimin e Grupit Teknik Multidisiplinar në lidhje me:**

- Funksionimin dhe pjesëmarrjen e aktorëve
- Periodicitetin e takimeve
- Problematikat

*(shtoni faqe të tjera nëse është e nevojshme)*

**Viti 2016 (Janar-Dhjetor 2016)**

**4. Informacion në lidhje me aktivitetet informuese/ndërgjegjësuese sipas tematikës dhe periodicitetit**

*(shtoni faqe të tjera nëse është e nevojshme)*

**Viti 2016 (Janar-Dhjetor 2016)**

**5. Cilat janë tematika e trajnimeve, praktikat e reja të fituara dhe ndarjen e eksperiencave** *(shtoni faqe të tjera nëse është e nevojshme)*

**Viti 2016 (Janar-Dhjetor 2016)**

**Plotësoni të dhënat më poshtë:**

Emri/ Mbiemri i punonjësit të NJMF \_\_\_\_\_

Cel: \_\_\_\_\_

Email: \_\_\_\_\_

Data e emërimit në punë si NJMF \_\_\_\_\_

Emer/Mbiemër i drejtuesit të NJMF \_\_\_\_\_

## ANEKS 2 – Lista e NJMF-ve që kanë raportuar dhe numri i rasteve të menaxhuara për 2016

	Bashkia	Qendra e bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Nr i rasteve të menaxhuara në total
1	Elbasan	Qyteti Elbasan	Elbasan	145
2	Tiranë	Qyteti Tiranë	Njësia Bashkiake Nr. 4	103
3	Shkodër	Qyteti Shkodër	Shkodër	95
4	Cërrik	Qyteti Cërrik	Cërrik	87
5	Tiranë	Qyteti Tiranë	Njësia Bashkiake Nr. 9	82
6	Kuqovë	Qyteti Kuqovë	Kuqovë	81
7	Fier	Qyteti Fier	Fier	79
8	Vlorë	Qyteti Vlorë	Vlorë	50
9	Tiranë	Qyteti Tiranë	Njësia Bashkiake Nr. 7	43
10	Tiranë	Qyteti Tiranë	Njësia Bashkiake Nr. 3	40
11	Durrës	Qyteti Durrës	Durrës	39
12	Sarandë	Qyteti Sarandë	Sarandë	35
13	Librazhd	Qyteti Librazhd	Librazhd	26
14	Tiranë	Qyteti Tiranë	Njësia Bashkiake Nr. 6	25
15	Tiranë	Qyteti Tiranë	Njësia Bashkiake Nr. 1	21
16	Tiranë	Qyteti Tiranë	Njësia Bashkiake Nr. 5	18
17	Tiranë		Bërzhitë	18
18	Pogradec	Qyteti Pogradec	Pogradec	17
19	Gjirokastër	Qyteti Gjirokastër	Gjirokastër	16
20	Berat	Qyteti Berat	Berat	14
21	Lezhë		Balldre	14
22	Prrenjas	Qyteti Prrenjas	Prrenjas	13
23	Patos	Qyteti Patos	Patos	13
24	Tiranë	Qyteti Tiranë	Njësia Bashkiake Nr. 2	13
25	Tiranë	Qyteti Tiranë	Njësia Bashkiake Nr. 11	12
26	Ura Vajgurore	Qyteti Ura Vajgurore	Ura - Vajgurore	11
27	Lushnje	Qyteti Lushnje	Lushnje	11
28	Tiranë	Qyteti Tiranë	Njësia Bashkiake Nr. 8	11
29	Kamëz		Paskuqan	11
30	Kolonjë	Qyteti Ersekë	Qëndër Ersekë	10
31	Kukës	Qyteti Kukës	Kukës	10
32	Lezhë	Qyteti Lezhë	Lezhë	9



33	<b>Kavajë</b>	Qyteti Kavajë	Kavajë	9
34	<b>Tiranë</b>		Kashar	8
35	<b>Vlorë</b>		Shushicë	8
36	<b>Malësi e Madhe</b>	Qyteti Koplík	Koplík	7
37	<b>Tiranë</b>		Vaqarr	7
38	<b>Tiranë</b>		Ndroq	7
39	<b>Kamëz</b>	Qyteti Kamëz	Kamëz	7
40	<b>Korçë</b>	Qyteti Korçë	Korçë	6
41	<b>Shkodër</b>		Postribë	6
42	<b>Tiranë</b>		Farkë	6
43	<b>Tiranë</b>		Zall Bastar	6
44	<b>Tiranë</b>		Shëngjergj	6
45	<b>Himarë</b>	Qyteti Himarë	Himarë	6
46	<b>Belsh</b>	Qyteti Belsh	Belsh	5
47	<b>Dibër</b>	Qyteti Peshkopi	Peshkopi	4
48	<b>Durrës</b>		Sukth	4
49	<b>Durrës</b>		Rrashbull	4
50	<b>Devoll</b>	Qyteti Bilisht	Bilisht	4
51	<b>Mirditë</b>	Qyteti Rrëshen	Rrëshen	4
52	<b>Tiranë</b>		Dajt	4
53	<b>Tiranë</b>		Zall-Herr	4
54	<b>Kavajë</b>		Luz i Vogël	4
55	<b>Selenicë</b>	Qyteti Selenicë	Selenicë	4
56	<b>Selenicë</b>		Kotë	4
57	<b>Bulqizë</b>	Qyteti Bulqizë	Bulqizë	3
58	<b>Durrës</b>		Katund i Ri	3
59	<b>Gramsh</b>	Qyteti Gramsh	Gramsh	3
60	<b>Kurbin</b>	Qyteti Laç	Laç	3
61	<b>Tiranë</b>		Petrelë	3
62	<b>Rrogozhinë</b>		Kryevidh	3
63	<b>Vlorë</b>		Novoselë	3
64	<b>Dibër</b>		Maqellarë	2
65	<b>Mat</b>	Qyteti Burrel	Burrel	2
66	<b>Gramsh</b>		Pishaj	2
67	<b>Roskovec</b>	Qyteti Roskovec	Roskovec	2
68	<b>Finiq</b>		Finiq	2
69	<b>Mat</b>		Komsi	1
70	<b>Klos</b>	Qyteti Klos	Klos	1
71	<b>Shijak</b>	Qyteti Shijak	Shijak	1
72	<b>Krujë</b>	Qyteti Krujë	Krujë	1

73	<b>Krujë</b>		Thumanë	1
74	<b>Roskovec</b>		Kuman	1
75	<b>Mallakastër</b>	Qyteti Ballsh	Ballsh	1
76	<b>Libohovë</b>	Qyteti Libohovë	Libohovë	1
77	<b>Dropull</b>	Fshati Sofratikë	Dropull i Poshtëm	1
78	<b>Korçë</b>		Voskop	1
79	<b>Maliq</b>	Qyteti Maliq	Maliq	1
80	<b>Tiranë</b>		Baldushk	1
81	<b>Vorë</b>	Qyteti Vorë	Vorë	1
82	<b>Vlorë</b>		Orikum	1
83	<b>Delvinë</b>	Qyteti Delvine	Delvinë	1
84	<b>Berat</b>		Velabisht	0
85	<b>Berat</b>		Otlak	0
86	<b>Berat</b>		Roshnik	0
87	<b>Ura Vajgurore</b>		Poshnje	0
88	<b>Kucovë</b>		Kozare	0
89	<b>Skrapar</b>	Qyteti Çorovodë	Çorovodë	0
90	<b>Skrapar</b>		Potom	0
91	<b>Skrapar</b>		Leshnje	0
92	<b>Poliçan</b>	Qyteti Poliçan	Poliçan	0
93	<b>Dibër</b>		Arras	0
94	<b>Mat</b>		Lis	0
95	<b>Durrës</b>		Ishëm	0
96	<b>Shijak</b>		Maminas	0
97	<b>Shijak</b>		Xhafzotaj	0
98	<b>Shijak</b>		Gjepalaj	0
99	<b>Krujë</b>		Fushë-Krujë	0
100	<b>Krujë</b>		Bubq	0
101	<b>Krujë</b>		Nikël	0
102	<b>Elbasan</b>		Labinot-Mal	0
103	<b>Cërrik</b>		Mollas	0
104	<b>Belsh</b>		Grekan	0
105	<b>Belsh</b>		Fierzë	0
106	<b>Belsh</b>		Gjocaj	0
107	<b>Belsh</b>		Shezë	0
108	<b>Gramsh</b>		Kodovjat	0
109	<b>Gramsh</b>		Kushovë	0
110	<b>Gramsh</b>		Poroçan	0
111	<b>Gramsh</b>		Sult	0
112	<b>Prrenjas</b>		Rrajcë	0

113	<b>Fier</b>		Levan	0
114	<b>Patos</b>		Ruzhdie	0
115	<b>Lushnje</b>		Allkaj	0
116	<b>Mallakastër</b>		Hekal	0
117	<b>Mallakastër</b>		Kutë	0
118	<b>Bashkia Divjakë</b>	Qyteti Divjakë	Divjakë	0
119	<b>Pustec</b>	Fshati Pustec	Pustec (Liqenas)	0
120	<b>Pogradec</b>		Buçimas	0
121	<b>Pogradec</b>		Trebinjë	0
122	<b>Kukës</b>		Tërthore	0
123	<b>Kukës</b>		Shtiqën	0
124	<b>Kukës</b>		Gjinaj	0
125	<b>Tropojë</b>	Qyteti Bajram Curri	Bajram Curri	0
126	<b>Tropojë</b>		Bujan	0
127	<b>Fushë Arrëz</b>	Qyteti Fushë-Arrëz	Qafë-Mali	0
128	<b>Tiranë</b>	Qyteti Tiranë	Njësia Bashkiake Nr. 10	0
129	<b>Tiranë</b>		Pezë	0
130	<b>Vorë</b>		Bërxullë	0
131	<b>Kavajë</b>		Synej	0
132	<b>Kavajë</b>		Golem	0
133	<b>Rrogozhinë</b>	Qyteti Rrogozhinë	Rrogozhinë	0
134	<b>Rrogozhinë</b>		Lekaj	0
135	<b>Rrogozhinë</b>		Gosë	0
136	<b>Sarandë</b>		Ksamil	0
137	<b>Konispol</b>	Qyteti Konispol	Konispol	0
138	<b>Finiq</b>	Fshati Dermish	Livadhja	0
139	<b>Finiq</b>		Dhivër	0
140	<b>Finiq</b>		Aliko	0
141	<b>Finiq</b>		Mesopotam	0